



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2022 – Numri: 152

Tiranë – E martë, 15 nëntor 2022

PËRMBAJTJA

		Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13870, datë 11.11.2022	Për dhënie të shtetësisë shqiptare.....	18269
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 344, datë 9.11.2022	Për shfuqizimin e urdhrit nr. 481, datë 26.12.2018, “Për ngarkim në detyrë”.....	18269
Urdhër i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 345, datë 10.11.2022	Për delegimin e kompetencave.....	18269
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 24, datë 11.10.2022	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 00-2021-1820, datë 15.11.2021, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; nr. 3866, datë 21.9.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	18270
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 25, datë 13.10.2022	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr. 00-2021-815, datë 21.10.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 132, datë 1.6.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 8, datë 20.4.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	18278
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 271, datë 27.10.2022	Mbi kërkesën e deputetes znj. Jorida Tabaku për rishikimin dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 242, datë 23.9.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kwh në muaj”...	18286
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 272, datë 27.10.2022	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e ALPEX përkufizimet, procedura e tregtimit, si dhe procedura e kërimit dhe e shlyerjes)	18288
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 273, datë 27.10.2022	Mbi rishikimin e kontratës ndërmjet shoqërive KESH sh.a. dhe FTL sh.a., për periudhën kohore 1.1.2022 deri më 31.12.2022.....	18290

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 274, datë 27.10.2022	Mbi rishikimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen, plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a., për periudhën kohore 1.1.2022 deri më 31.12.2022.....	18292
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 275, datë 27.10.2022	Mbi licencimin e shoqërisë “H&K@Vala Mar Residences” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	18295
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 276, datë 27.10.2022	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	18296
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 277, datë 27.10.2022	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “BIGWIND” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiq, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier.....	18297
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 282, datë 7.11.2022	Mbi zgjatjen e vendimarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k.....	18298
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 283, datë 7.11.2022	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	18300
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 284, datë 7.10.2022	Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 150, datë 10.6.2022, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘ <i>Danske Commodities Albania</i> ’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.....	18301
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 623/11, datë 11.11.2022	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës ekzistuese ‘Grigor Nosi’, ‘Hasan Ali Kopili’ dhe ‘Xhaferr Duhanxhiu’ në ZK 8527”, Bashkia Elbasan.....	18302



DEKRET
Nr. 13870, datë 11.11.2022

PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, shkronjës “c”, dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të nenit 6, nenit 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozim të ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

Dhënien e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Shqipërim Mehdi Peposhi
2. Norik Kreshnik Spahiu
3. Fatime Nezir Avdyli (Prushi)
4. Zenel Sadik Avdyli
5. Nicolas Peter Ndue Ulaj
6. Gent Agron Muhaxhiri
7. Lirijan Arsim Muhametaj
8. Sali Bajram Koci
9. Gazmend Xhavit Nixha
10. Fluriye Hasan Metlilo (Santur)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

URDHËR
Nr. 344, datë 9.11.2022

PËR SHFUQIZIMIN E URDHËRIT
NR. 481, DATË 26.12.2018, “PËR
NGARKIM NË DETYRË”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe në vijim të shkresës së Agjencisë Kombëtare të

Turizmit nr. 607 prot, datë 7.11.2022 protokolluar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit me nr. 8126 prot., datë 7.11.2022, lënda “Kërkesë për revokim urdhri nr. 481, datë 26.12.2018, ‘Për ngarkim në detyrë’”,

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrit nr. 481, datë 26.12.2018, “Për ngarkim në detyrë”.

2. Znj. Kornelia Ferizaj, të përgatisë një raport të detajuar të të gjithë aktiviteteve të vitit 2022, si dhe të marrë masat për të përfunduar procedurat dhe detyrat e iniciuara prej saj në cilësinë e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Turizmit, i komanduar në detyrë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

URDHËR
Nr. 345, datë 10.11.2022

për DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”; të nenit 11, pika 2, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e Administratës Shtetërore”; të VKM-së nr. 298, datë 20.4.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit”; të shkresës së Agjencisë Kombëtare të Turizmit nr. 607 prot, datë 7.11.2022, protokolluar në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit me nr. 8126 prot., datë 7.11.2022, lënda “Kërkesë për revokim urdhri nr. 481, datë 26.12.2018, ‘Për ngarkim në detyrë’”; si dhe të urdhrit të ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 344, datë 9.11.2022, “Për shfuqizimin e urdhrit nr. 481, datë 26.12.2018, ‘Për ngarkim në detyrë’”, deri në plotësimin e këtij pozicioni, konform procedurave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar,



URDHËROJ:

1. Znj. Ledina Beqiraj Agalliu, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të ushtrojë detyrat e drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Turizmit, krahas detyrave si Sekretar i Përgjithshëm i MTM-së.

2. Këto kompetenca nuk mund të nëndelegohen.

3. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit.

4. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Miradministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve Mbështetëse, si dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT
Mirela Kumbaro Furxhi

VENDIM
Nr. 24, datë 11.10.2022

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare,
Marsida Xhaferllari	anëtare,
Elsa Toska	anëtare,
Altin Binaj	anëtar,
Sonila Bejtja	anëtare,
Sandër Beci	anëtar,
Ilir Toska	anëtar,
Fiona Papajorgji	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 11.10.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, çështjen nr. 1 (I) 2022 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Ilir Goci, Mustafa Goci

SUBJEKTE TË INTERESUARA: SHOQË-
RIA MURATI SH.P.K.,
BASHKIM KULLAJ,
AVOKATURA E SHTETIT,
BASHKIA KRUJË,
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS,
DREJTORIA VENDORE, KRUJË

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 00-2021-1820, datë 15.11.2021, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë; nr. 3866, datë 21.9.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Fiona Papajorgji, mori në shqyrtim pretendimet e paraqitura nga kërkuesit, që kërkuan pranimin e kërkesës, parashtrimet e subjekteve të interesuara, shoqërisë “Murati” sh.p.k. dhe Bashkim Kullaj, që kërkuan rrëzimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjekteve e tjera të interesuara, Avokaturës së Shtetit, Bashkisë Krujë dhe Agjencisë së Kadastrës, Drejtoria Vendore, Krujë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, Krujë (KKKP-ja Krujë), me vendimin nr. 175, datë 16.6.1997, i ka njohur dhe kthyer kërkuesit Ilir Goci, si trashëgimtar i trashëgimlënësit M.G., truallin, me sipërfaqe 240 m², të ndodhur në qytetin e Krujës. Vendimi është regjistruar në regjistrat hipotekore.

2. Ndërkohë, sipërfaqja e lartpërmendur rezulton të jetë e regjistruar në regjistrat hipotekore edhe në emër të subjektit të interesuar, Bashkim Kullaj. Ky i fundit, me kontratën e shitblerjes së datës 21.12.1998, ka blerë nga shtetasi M.K. tokën truall me sipërfaqe 850 m², pronë kjo e blerë nga trashëgimtarët e shtetases F.M., të cilëve, me vendimin nr. 156, datë 10.3.1995, të KKKP-së, Krujë iu ishte kthyer sipërfaqja e truallit prej 2.224 m². Gjithashtu, mbi bazë të marrëveshjes me subjektin tjetër të interesuar, shoqërinë “Murati”



sh.p.k., në sipërfaqen prej 240 m² është bërë një ndërtim.

3. Kërkuesi Ilir Goci ka pretenduar se prona e tij është zënë nga ndërtimi i lartpërmendur, prandaj në datën 17.1.2013 i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë me kërkesëpadi me objekt: *“Sigurimin e padisë. Detyrimin e të paditurve për njohjen pronar të paditësit mbi sipërfaqen 240 m². Detyrimin e kthimit të pronës prej 240 m² pronarëve të ligjshëm, e cila mbahet nga poseduesit pa ndonjë dokument të ligjshëm dhe kthimin e pronës në gjendjen e mëparshme. Pavlefshmërinë e lejes së ndërtimit dhënë shoqërisë së ndërtimit “Murati” sh.p.k, çregjistrimin pjesërisht të certifikatës së pronësisë, vetëm në lidhje me sip. 240 m² regjistruar në emër të Bashkim Kullaj.”* Në procesin gjyqësor është thirrur si person i tretë Mustafa Goci, kërkuesi tjetër në gjykimin kushtetues.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr. 93, datë 13.3.2014, ka vendosur: *“Shpalljen e moskompetencës në lidhje me çështjen civile nr. 38/282 akti, datë 17.1.2013 regjistrimi. Dërgimin e akteve për këtë çështje Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, së cilës i përket edhe kompetenca lëndore në lidhje me këtë çështje”,* me arsyetimin se janë parashtruar së bashku kërtime të natyrës civile dhe administrative.

5. Kërkuesit Ilir Goci dhe Mustafa Goci kundër vendimit kanë paraqitur ankim të veçantë në Gjykatën e Lartë, e cila, me vendimin nr. 29, datë 6.5.2014, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 93, datë 13.3.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë.

6. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, së cilës i janë dërguar aktet, me vendimin nr. 7503/425 registri, datë 31.3.2015, ka vendosur: *“Veçimin e kërtimeve të kërkesëpadi dhe konkretisht: Detyrimin e të paditurve të më njohin pronarë të sip. 240 m², e cila mbahet nga poseduesit pa ndonjë dokument të ligjshëm dhe kthimin e saj në gjendjen e mëparshme. Shpalljen e moskompetencës lëndore dhe dërgimin e akteve në lidhje me këto kërtime, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, si gjykata kompetente nga pikëpamja lëndore dhe tokësore.”* Ky vendim nuk është kundërshtuar nga palët ndërgjyqëse dhe për këtë arsye janë zhvilluar njëkohësisht dy procese gjyqësore, njëri proces me kërtime të natyrës juridiko-civile dhe tjetri me kërtime të natyrës juridiko-administrative.

7. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë është zhvilluar procesi gjyqësor me objekt: *“Detyrimin e të paditurve për njohjen pronar të paditësit mbi sipërfaqen 240*

m². Detyrimin e kthimit të pronës prej 240 m² pronarëve të ligjshëm, e cila mbahet nga poseduesit pa ndonjë dokument të ligjshëm dhe kthimin e pronës në gjendjen e mëparshme.” Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. 314, datë 14.6.2016, është vendosur pranimi pjesërisht i kërkesëpadi dhe detyrimi i të paditurve ta njohin kërkuesin pronar në sipërfaqen e truallit 155 m², të ndodhur në qytetin e Krujës. Rrëzimi i kërkesëpadi për pjesën tjetër të objektit, njohjen pronar të sipërfaqes prej 85 m² për mungesë legjitimitimi të kërkuesit, si dhe të kërimit për kthimin e pronës në gjendjen e mëparshme.

8. Pas ankimit të kërkuesve, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 348, datë 24.11.2020, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 314, datë 14.6.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po këtë gjykatë, me tjetër trup gjyqësor. Ndaj këtij vendimi ka ushtruar rekurs kërkuesi Ilir Goci. Bazuar në të dhënat e faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, çështja civile është ende në shqyrtim.

9. Ndërkohë, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është zhvilluar procesi me objekt kërkesëpadi çregjistrimin pjesërisht të pasurive nr. 3/953 dhe nr. 3/929, në lidhje me sipërfaqen 240 m² të regjistruar në emër të subjektit të interesuar, Bashkim Kullaj dhe detyrimin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Krujë (ZVRPP, Krujë) për të bërë ndryshimet përkatëse. Kërkuesi Ilir Goci ka kërkuar pakësimin e objektit të kërkesëpadi në lidhje me kërkesën për pavlefshmërinë e lejes së ndërtimit të dhënë shoqërisë, kërkesë e cila është pranuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

10. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 2666, datë 18.5.2015, ka vendosur pranimin e kërkesëpadi të kërkuesit Ilir Goci dhe detyrimin e ZVRPP-së, Krujë të bëjë çregjistrimin e pjesshëm të pasurisë nr. 3/929 për sipërfaqen 160 m² dhe të pasurisë nr. 3/953 për sipërfaqen 80 m² të regjistruara në emër të Bashkim Kullaj.

11. Pas ankimit të disa prej subjekteve të interesuara, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 3866, datë 21.9.2017, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 2666, datë 18.5.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes me arsyetimin se paditësi ka ngritur një padi që nuk mund të ngrihej pa iu drejtuar më parë organit administrativ.



12. Kundër vendimit kanë paraqitur rekurs kërkesit Ilir Goci dhe Mustafa Goci, si dhe kundërrekues shoqëria “Murati” sh.p.k. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-1820, datë 15.11.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit të paraqitur nga kërkesit.

13. Kërkesit në datën 15.3.2022 i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual sipas objektit. Kolegji i Gjykatës në datën 13.5.2022 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

14. Kërkesit kanë parashtruar, në mënyrë të përmbledhur, se vendimet objekt kundërshtimi kanë cenuar:

14.1 *Parimin e barazisë së armëve dhe të drejtën për t'u mbrojtur*, pasi Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka marrë në shqyrtim apelin kundërshtues, duke e konsideruar të paraqitur jashtë afatit ligjor. Ata kanë marrë dijeni për ankimin e shoqërisë “Murati” sh.p.k. në datën 11.6.2015 dhe kanë dorëzuar apelin kundërshtues në datën 15.6.2015, ndërsa për ankimin e ZVRPP-së, Krujë kanë marrë dijeni nëpërmjet shërbimit postar në datën 18.6.2015.

14.2 *Parimin e paanshmërisë*, pasi gjyqtari A.V., i cili ka qenë pjesë e trupit gjykues në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë në vitin 2021, ka qenë pjesë edhe e trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë që ka gjykuar çështjen me kërkitime të natyrës civile, konkretisht detyrimin për të njohur kërkesin pronar të sipërfaqes 240 m², për të cilën është dhënë vendimi nr. 348, datë 24.11.2020 nga Gjykata e Apelit Tiranë.

14.3 Gjykata Administrative e Apelit nuk ka bërë gjykim të drejtë, pasi nuk duhej të prishte vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me arsyetimin se kërkesi nuk legjitimohej në ngritjen e padisë, në kushtet kur Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë e ka pranuar gjykimin e padisë, duke e legjitimuar kërkesin Ilir Goci si paditës.

15. **Subjekti i interesuar, shoqëria “Murati”** sh.p.k., në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

15.1 *Pretendimet për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor* nuk janë të bazuara, pasi vendimet nr. 00-2021-1820, datë 15.11.2021, të Kolegjit

Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe nr. 3866, datë 21.9.2017 të Gjykatës Administrative të Apelit janë marrë në zbatim të ligjit material dhe procedural. Ndërsa pretendimet për të drejtën e pronësisë kanë lindur pas përfundimit të ndërtimit nga shoqëria “Murati” sh.p.k., sipas marrëveshjes me pronarin e truallit referuar vërtetimit nga dokumentet hipotekore, ndaj për kërkitimet e parashtruara nga kërkesit mbartin detyrime vetëm ZVRPP-ja, Krujë dhe Bashkim Kullaj.

16. **Subjekti i interesuar, Bashkim Kullaj**, në mënyrë të përmbledhur, ka prapësuar se:

16.1 Kërkesa e paraqitur në Gjykatë nuk përmblush kriteret formale dhe ligjore të parashikuara për përpilimin e kërkesave drejtuar kësaj Gjykate, pasi është emërtuar ankim, nuk është firmosur në çdo faqe, nuk janë përcaktuar subjektet e interesuara dhe baza ligjore është vetëm ajo që ka shërbyer për të paraqitur padinë.

16.2 Pretendimi se është cenuar *parimi i barazisë së armëve dhe e drejta për t'u mbrojtur*, pasi nuk është marrë në shqyrtim ankimi kundërshtues, është i pabazuar. Kërkesit nuk kanë paraqitur prova për të vërtetuar se kanë marrë dijeni për ankimin në datën 9.6.2015.

16.3 Pretendimi për cenimin e *parimit të paanshmërisë* është i pabazuar, pasi gjyqtari A.V., ka marrë pjesë në dy gjykime të ndryshme. Ai ka qenë në vitin 2020 në Gjykatën e Apelit Tiranë, ku është dhënë vendimi nr. 348, datë 24.11.2020 për çështjen civile me objekt njohjen pronar të kërkesit Ilir Goci, ndërsa çështja e shqyrtuar nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë në vitin 2021 ka si objekt çregjistrimin pjesërisht të certifikatës së pronësisë në lidhje me sipërfaqen prej 240 m².

16.4. Në ankimin e paraqitur në Gjykatë dhe në parashtrime nuk janë paraqitur shkaqe që mund të përbëjnë shkelje kushtetuese dhe të jetë cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor, në aspekt të aksesit në gjykatë, standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor ose të gjykimit nga një gjykatë e caktuar me ligj.

17. **Subjektet e interesuara, Avokatura e Shtetit, Bashkia Krujë dhe Agjencia e Kadastrës, Drejtoria Vendore, Krujë** edhe pse janë njoftuar rregullisht, nuk kanë paraqitur parashtrime me shkrim.



III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkesësve

18. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, nenit 134, pika 1, shkronja “I” dhe nenit 134, pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

19. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të parashikuara në nenin 71/a, të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

20. Subjekti i interesuar, Bashkim Kullaj, ka prapësuar se kërkesa e paraqitur në Gjykatë nuk përmbush kriteret formale dhe ligjore të parashikuara për përpilimin e kërkesave drejtuar kësaj Gjykate, pasi është emërtuar ankimi, nuk është firmosur në çdo faqe, nuk janë përcaktuar subjektet e interesuara dhe baza ligjore është vetëm ajo që ka shërbyer për të paraqitur padinë.

21. Në ndryshim nga sa pretendon subjekti i interesuar, Gjykata thekson se në shqyrtimin e kriterëve ligjore që duhet të përmbajë ankimi kushtetues individual rëndësi për gjykimin kushtetues merr përmbajtja e kërkesës së paraqitur në Gjykatë, pavarësisht anës formale të saj (titulli ose baza ligjore) dhe se elementet formale të kundërshtuara nuk pengojnë shqyrtimin e saj. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkesa i përmbush kriteret ligjore dhe formale të paraqitjes së saj.

22. Në vijim, Gjykata vlerëson se kërkesit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të shkronjës “P”, të pikës 1, të nenit 131 dhe shkronjës “I”, të pikës 1, të nenit 134, të Kushtetutës, pasi janë palë ndërgjyqëse në vendimet objekt kundërshtimi, si dhe kanë interes të drejtpërdrejtë në çështjen konkrete.

23. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se kërkesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkesi, i cili para se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 38, datë 25.4.2017, të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, duhet theksuar se bëhet fjalë për shterimin e mjeteve juridike *efektive*, në kuptimin e shterimit të atyre mjeteve që janë të afta për të rivendosur të drejtën që pretendohet se është shkelur (*shih vendimet nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 31, datë 4.10.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Ky rregull nënkupton jo vetëm që individ i t’u jetë drejtuar të gjitha instancave të zakonshme, por edhe që të gjitha pretendimet që ngre në këtë Gjykatë t’i ketë paraqitur më parë në këto instanca, të paktën në substancë, duke respektuar kërkesat formale dhe afatet e parashikuara në ligjin procedural (*shih vendimin nr. 15, datë 7.5.2018, të Gjykatës Kushtetuese*). Prandaj, shkelja e të drejtave kushtetuese mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pas ezaurimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i apeli meve (*shih vendimet nr. 45, datë 1.11.2013; nr. 10, datë 9.5.2005; nr. 10, datë 2.4.2003, të Gjykatës Kushtetuese*).

25. Në rastin konkret, kërkesit i janë drejtuar Gjykatës me ankimi kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, duke pretenduar shfuqizimin e vendimit të këtij kolegji për shkak të cenimit të parimit të paanshmërisë, si dhe shfuqizimin e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit për shkak të cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe të së drejtës për t’u mbrojtur, pasi nuk është marrë në shqyrtim apeli i tyre kundërshtues.

26. Gjykata paraprakisht vëren se apeli kundërshtues i paraqitur në një akt të vetëm në Gjykatën Administrative të Apelit është nënshkruar nga avokati E.D., përfaqësues i kërkesit Ilir Goci dhe nga kërkesi tjetër Mustafa Goci. Pretendimi për mosmarrjen në shqyrtim të tij nga Gjykata



Administrative e Apelit është parashtruar vetëm në rekursin e paraqitur nga kërkuesi Mustafa Goci. Gjithsesi, në rrethanat kur të dy kërkuesit janë palë në procesin gjyqësor dhe paraqitja e apelit kundërshtues ka efekte juridike për të dy, Gjykata vlerëson se janë shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion.

27. Për sa i përket legjitimitetit *ratione temporis*, në shkronjën “b”, pika 1, e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se afati për paraqitjen e ankimit kushtetues individual është 4 muaj nga konstatimi i cenimit të së drejtës. Nga aktet bashkëlidhur kërkesës rezulton se procesi gjyqësor i kundërshtuar nga kërkuesit ka përfunduar me vendimin nr. 00-2021-1820, datë 15.11.2021, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, kurse ankimi kushtetues individual është depozituar në Gjykatë në datën 15.3.2022, pra brenda afatit ligjor të lartpërmendur.

28. Në lidhje me legjitimitetin *ratione materiae*, Gjykata vëren se kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur në mënyrë të padrejtë prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Gjithashtu, kërkuesit kanë parashtruar se është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në këndvështrim të parimit të barazisë së armëve e të së drejtës për t’u mbrojtur, si dhe të parimit të paanshmërisë.

29. Për sa i përket pretendimit se Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur në mënyrë të padrejtë prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nga përmbajtja e vendimit nr. 2666, datë 18.5.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë rezulton se gjykata e ka legjitimuar kërkuesin Ilir Goci si paditës bazuar në nenin 37, pika 3, të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, sipas të cilit: “Në rastet kur dokumentet e paraqitura për regjistrim krijojnë mbivendosje, me një pasuri të regjistruar më parë, regjistruesi, me urdhër të arsyetuar, refuzon regjistrimin e pasurisë për atë pjesë që krijon mbivendosje, deri në zgjidhjen gjyqësore dhe orienton kërkuesin për zgjidhjen e çështjes në rrugë administrative a gjyqësore.”. Ndërsa Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar se kërkuesit nuk legjitimohen në ngritjen e padisë, pasi gjykata administrative nuk mund të angazhohet pa u shprehur më parë organi administrativ ose pa kaluar afati i parashikuar për moskthimin e një përgjigjeje nga organi

administrativ edhe pse ka pasur kërkesë nga personi dhe “në rastin në shqyrtim nuk ka një kërkesë nga personi dhe nuk ka se si të ketë përgjigje apo mosveprim nga administrata” (shih faqen 20 e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit).

30. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se interpretimi i ligjit dhe zbatimi i tij në çështjen konkrete, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues. Megjithatë, Gjykata ndërhyr në ato raste, kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve. Në këto raste, Gjykata nuk bën rivlerësimin e fakteve e të rrethanave, por një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (shih vendimet nr. 3, datë 17.2.2022; nr. 2, datë 17.2.2022, të Gjykatës Kushtetuese).

31. Në rastin në shqyrtim Gjykata çmon se ky pretendim i kërkuesve ka të bëjë me interpretimin e ligjit, i cili nuk rezulton të lidhet me cenimin e ndonjë të drejte kushtetuese, dhe si i tillë nuk hyn në juridiksionin kushtetues, prandaj në vijim do të analizohen pretendimet e tjera të kërkuesve.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1 Për pretendimin e cenimit të parimit të barazisë së armëve dhe të së drejtës për t’u mbrojtur.

32. Kërkuesit kanë pretenduar se Gjykata Administrative e Apelit nuk e ka marrë në shqyrtim apelin kundërshtues, duke e konsideruar të paraqitur jashtë afatit ligjor. Për ankimin e shoqërisë “Murati” sh.p.k. ata kanë marrë dijeni në datën 11.6.2015 dhe apeli kundërshtues është dorëzuar në datën 15.6.2015, ndërsa për ankimin e ZVRPP-së, Krujë kanë marrë dijeni nëpërmjet shërbimit postar në datën 18.6.2015.

33. Subjekti i interesuar, shoqëria “Murati” sh.p.k. ka prapësuar se vendimet nr. 00-2021-1820, datë 15.11.2021 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë dhe nr. 3866, datë 21.9.2017, të Gjykatës Administrative të Apelit janë marrë në zbatim të ligjit material dhe procedural. Ndërsa, subjekti i interesuar, Bashkim Kullaj, ka prapësuar se pretendimi se nuk është marrë në shqyrtim ankimi kundërshtues është i pabazuar. Kërkuesit nuk kanë paraqitur prova për të vërtetuar se janë njohur me ankimin në datën 9.6.2015.

34. Gjykata vëren se kërkuesit në ankimin kushtetues individual nuk kanë parashtruar



shprehimisht se ky pretendim lidhet me cenimin e ndonjë të drejte kushtetuese ose të një parimi konkret, por, në thelb, ai lidhet me cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të së drejtës për t'u mbrojtur gjatë gjykimit, të cilin Gjykata do ta analizojë në vijim.

35. Në jurisprudencën kushtetuese për parimin e barazisë së armëve është theksuar se çdo palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e saj. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk është formale, ku palëve iu garantohet thjesht prania fizike gjatë procesit gjyqësor, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe, më pas, gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve në gjykim, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës tjetër, për rrjedhojë e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar procesin e rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 34, datë 29.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

36. Gjykata rithekson se shqyrtimi i çështjes dhe nxjerrja e konkluzioneve nga gjykata vetëm mbi bazën e provave të paraqitura nga një palë, pa dëgjuar pretendimet e palës tjetër, e bën të cenueshëm procesin gjyqësor. E drejta për proces të rregullt gjyqësor përfshin edhe të drejtën e të dyja palëve në proces për të pasur informacion për argumentet e palës kundërshtare, që nënkupton në parim mundësinë që palët në një seancë gjyqësore të kenë njohuri edhe për komentet mbi provat e nxjerrja. Në këtë mënyrë gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklarimit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 34, datë 29.5.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

37. Në rastin në shqyrtim, nga përmbajtja e dosjes gjyqësore, Gjykata konstaton se ndaj vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë kanë paraqitur ankim shoqëria “Murati” sh.p.k., Bashkim Kullaj dhe ZVRPP-ja, Krujë. Ato fillimisht kanë paraqitur kërkesë për zënien e afatit të ankimit dhe më pas ankimin ndaj

vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Konkretisht, rezulton se ankimi i plotë i shoqërisë “Murati” sh.p.k. i është njoftuar kërkuessit Ilir Goci në datën 11.6.2015. Ndërsa ankimi i plotë i ZVRPP-së, Krujë është njoftuar në datën 18.6.2015.

38. Gjykata konstaton, gjithashtu, se apeli kundërshtues i kërkuessve është depozituar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë në datën 15.6.2015 dhe është firmosur nga avokati E.D., përfaqësues i kërkuessit Ilir Goci dhe nga kërkuessi Mustafa Goci, si dhe u është komunikuar të gjitha palëve në atë proces gjyqësor.

39. Gjykata vëren se nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit në lidhje me paraqitjen e apelit kundërshtues, ajo ka arsyetuar: *“Shoqëria “Murati” sh.p.k., ka paraqitur kërkesë për zënien e afatit të ankimit në datën 22.5.2015, të cilin më pas e ka plotësuar me dorëzimin e ankimit të plotë në datën 9.6.2015, pra brenda afatit të përcaktuar në nenet 443 paragrafi i parë dhe 444 paragrafi i parë i KPC-së. Referuar dëftesës së komunikimit të ankimit të datës 4.6.2015, pala paditëse, Ilir Goci, ka marrë dijeni mbi ankimin e palës së paditur, shoqëria “Murati” shpk, në datën 4.6.2015. Apeli kundërshtues nga pala paditëse, Ilir Goci, është paraqitur në datën 15.6.2015, pra jashtë afatit të përcaktuar në nenin 456 të KPC-së, për pasojë apeli kundërshtues i palës paditëse nuk do të merret në shqyrtim nga Gjykata Administrative e Apelit”* (*shih faqet 16-17 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit*).

40. Gjykata konstaton se Gjykata Administrative e Apelit në llogaritjen e afatit të përcaktuar në nenin 456 të Kodit të Procedurës Civile (KPC) për paraqitjen e apelit kundërshtues, ka marrë në konsideratë datën kur shoqëria “Murati” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për zënien e afatit të ankimit, duke mos u shprehur për datën kur kërkuessit kanë marrë dijeni për paraqitjen e ankimit të plotë.

41. Ndërkohë, nga përmbajtja e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit, Gjykata vëren se janë paraqitur të gjitha pretendimet e parashtruara nga kërkuessit në apelin kundërshtues. Një pjesë e tyre, në thelb, lidhen me parashtrimin kryesor të paraqitur në ankim edhe nga subjektet e interesuara, konkretisht se kërkuessit nuk kanë ezauruar rrugën administrative për zgjidhjen e mosmarrëveshjes të lindur gjatë regjistrimit të pronave në pronësi të tyre dhe të subjektit të interesuar Bashkim Kullaj. Ndërsa pretendimet e



tjera të parashtruara nga kërkuesit në apelin kundërshtues lidhen me cenimin e së drejtës së pronësisë nga ZVRPP-ja, Krujë gjatë regjistrimit të pronës.

42. Për pretendimin thelbësor të kërkuesve në apelin kundërshtues, Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar: *“Ligji i ka njohur organit administrativ mundësinë e korrigjimeve kur ka gabime në planvendosjen e pronave dhe këto gabime mund të zgjidhen në rrugë administrative. Vetëm në rast se organi administrativ refuzon t’i kryejë këto ndryshime që pretendohen nga palët vetëm atëherë personi mund t’i drejtohet gjykatës për zgjidhjen e çështjes, sepse vetëm në këtë moment ka lindur konflikti administrativ që mund të investojë gjykatën në zgjidhjen e tij. Në këto gjykime, Gjykata gjykon ligshmërinë e veprimit ose mosveprimit administrativ dhe jo çështje që kanë të bëjnë me të drejtën e pronësisë që janë lëndë për gjykatën civile”* (shih faqen 21 të vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit).

43. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur prishjen e vendimit nr. 2666, datë 18.5.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes. Ajo ka arsyetuar se padia fillestare e ngritur nga kërkuesit ishte me kërkitime të përziera administrative dhe civile, ku thelbi lidhej me përcaktimin e së drejtës së pronësisë për pronat e mbivendosura, ndërsa çregjistrimi i njëres ose tjetres pronë ishte pasojë e kësaj zgjidhjeje.

44. Nga sa më lart, Gjykata vlerëson se Gjykata Administrative e Apelit, duke mos u shprehur për datën se kur kërkuesit kanë marrë dijeni për paraqitjen e ankimit të plotë nga ana e subjekteve të interesuara dhe duke e konsideruar paraqitjen e apelit të tyre kundërshtues jashtë afatit ligjor, nuk ka respektuar rregullat procedurale në këtë drejtim.

45. Gjithsesi, në këtë këndvështrim, Gjykata është shprehur se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017, të Gjykatës Kushtetuese). Gjatë shqyrtimit të pretendimeve për të drejtën për proces të rregullt nuk mjafton vetëm konstatimi i shkeljes procedurale, por duhet të analizohet karakteri i saj, pasojat që kanë ardhur për kërkuesin dhe për

interesat që ai përfaqëson (shih vendimin nr. 38, datë 2.12.2021, të Gjykatës Kushtetuese).

46. Bazuar në këto konsiderata, Gjykata vëren se përderisa në thelb në vendimin e kundërshtuar u është dhënë përgjigje e arsyetuar pretendimeve të kërkuesve të parashtruara në apelin kundërshtues, fakti që Gjykata Administrative e Apelit e ka konsideruar atë si të paraqitur jashtë afatit ligjor nuk ka ndikuar drejtpërdrejt në zgjidhjen e mosmarrëveshjes dhe në zhvillimin e procesit gjyqësor në mënyrë të drejtë. Prandaj, Gjykata çmon se thjesht kjo rrethanë nuk është e mjaftueshme për ta konsideruar procesin gjyqësor të zhvilluar në atë gjykatë të parregullt në kuptimin kushtetues.

47. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuesve për cenimin e parimit të barazisë së armëve dhe të së drejtës së mbrojtjes gjatë gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit është i pabazuar.

B.2. Për pretendimin e cenimit të parimit të paanshmërisë

48. Kërkuesit kanë parashtruar se gjatë gjykimit në Gjykatën e Lartë është cenuar parimi i paanshmërisë, pasi gjyqtari i Gjykatës së Lartë A.V. ka qenë pjesë edhe e trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë gjatë gjykimit të çështjes me objekt detyrimin për të njohur kërkuesin pronar të sipërfaqes 240 m², për të cilën kjo gjykatë ka dhënë vendimin nr. 348, datë 24.11.2020.

49. Subjekti i interesuar, Bashkim Kullaj ka prapësuar se pretendimi për cenimin e parimit të paanshmërisë është i pabazuar, pasi gjyqtari A.V. ka marrë pjesë në dy gjykime të ndryshme.

50. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se parimi i paanshmërisë ka në vetvete elementin e vet *subjektiv*, i cili lidhet ngushtë me bindjen e brendshme që krijon gjyqtari për zgjidhjen e çështjes në gjykim, si dhe elementin *objektiv*, me të cilin kuptohet dhënia e garancive të nevojshme për gjykim të paanshëm nga vetë gjykata, përmes mënjanimi nga vetë ajo të çdo dyshimi të përligjur në këtë drejtim. Ndër të tjera, gjykata merr parasysh veçanërisht problemin e përbërjes së trupit gjykues, në mënyrë që të mënjanohej nga gjykimi i çështjes gjyqtarët që nuk kanë garancitë e kërkuara për paanshmëri në kuptimin objektiv. Gjykata çmon se paragjykimi eventual për paanshmëri të gjyqtarit mund të ngrihet në hipotezën se gjyqtari është shprehur në një procedim tjetër me një vlerësim që



ka të bëjë me përmbajtjen e të njëjtit fakt, në lidhje me të njëjtin subjekt. Në shtetin e së drejtës kërkesa për gjykim të paanshëm merr rëndësi të veçantë në funksion të besimit në dhënien e drejtësisë, që në shoqëritë demokratike duhet ta krijojnë në çdo rast jo vetëm palët në gjykim, por dhe çdo qytetar i thjeshtë (*shih vendimet nr. 15, datë 11.3.2021; nr. 6, datë 29.3.2018, të Gjykatës Kushtetuese*).

51. Gjykata vëren se në rastin konkret, sikurse u parashtrua, janë zhvilluar dy procese gjyqësore, njëri me kërkitime të natyrës juridiko-administrative (vendimet e të cilit janë objekt kundërshtimi në ankimin kushtetues individual) dhe tjetri me kërkitime të natyrës juridiko-civile.

52. Lidhur me procesin gjyqësor me objekt kërkitime të natyrës civile, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë, me vendimin nr. 314, datë 14.6.2016, ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë, pra detyrimin për të njohur kërkuuesin Ilir Goci pronar të sipërfaqes prej 240 m² (*shih paragrafët 6 dhe 7 të këtij vendimi*). Pas ankimit të kërkuësve, Gjykata e Apelit Tiranë, bazuar në nenet 466, shkronja “ç” dhe 467, shkronjat “b” dhe “e”, të KPC-së, me vendimin nr. 348, datë 24.11.2020, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 314, datë 14.6.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po këtë gjykatë, me tjetër trup gjykues, në mënyrë që kjo e fundit të hetojë lidhur me sqarimin e fakteve, si dhe cilësimin e duhur ligjor të tyre (*shih paragrafin e fundit të faqes 10 të vendimit të Gjykatës së Apelit Tiranë*). Gjykata e Apelit Tiranë i ka lënë detyrë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë për të hetuar lidhur me vendimet e KKKP-së, Krujë, sipas të cilave palët pretendojnë se kanë fituar pronësinë në mënyrë që të arrihet në përfundimin nëse ka ose jo mbivendosje ndërmjet tyre. Ajo ka prishur vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Krujë për shkaqe procedurale duke mos u shprehur për themelin e çështjes. Në përbërje të trupit gjykues në Gjykatën e Apelit Tiranë ka qenë edhe gjyqtari A.V.

53. Për sa i përket procesit gjyqësor me objekt kërkitime të natyrës administrative, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë, çregjistrimin e pjesshëm të pasurisë dhe detyrimin e ZVRPP-së Krujë që të bëjë ndryshimet përkatëse. Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

Kundër vendimit kanë paraqitur rekurs kërkuessit, si dhe kundërrekues shoqëria “Murati” sh.p.k. Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-1820, datë 15.11.2021, ka vendosur mospranimin e rekursit (*shih paragrafin 12 të këtij vendimi*). Në trupin gjykues që ka shqyrtuar çështjen në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë ka marrë pjesë edhe gjyqtari A.V.

54. Gjatë gjykimit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, trupi gjykues ka vlerësuar se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*) dhe ka arsyetuar: “*nuk ngrihen problematika në rekurs që të bëjnë të mendohet se gjykatat më të ulëta kanë zbatuar gabim ligjin material apo procedural dhe që ky keqzbatim të jetë i një rëndësie themelore për njehsimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore. Po ashtu asnjë shkelje e rëndë e normave procedurale nuk është parashtruar nga rekursuesi në mjetin e tij të ankimit para Gjykatës së Lartë*” (*shih paragrafin 26 të vendimit të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

55. Nga sa më lart, Gjykata çmon se pavarësisht se *prima facie* proceset gjyqësore kanë të bëjnë me të njëjtat palë dhe me të njëjtën pronë objekt shqyrtimi, në thelb, pretendimet dhe kërkitimet e kërkuësve në këto procese janë të natyrave ndryshme dhe me baza ligjore të ndryshme. Gjyqtari A.V. në procesin administrativ, gjatë shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit, jo vetëm që nuk ka shqyrtuar të njëjtën çështje si në procesin civil, por edhe në substancë ai nuk ka qenë në situatën që të jetë shprehur më parë në lidhje me të. Konkretisht, sikurse u theksua më lart, gjatë procesit gjyqësor civil, Gjykata e Apelit Tiranë nuk e ka zgjidhur çështjen që lidhet me cenimin e së drejtës së pronësisë të kërkuësve, por, bazuar në shkaqet e ankimi e ka kthyer atë për rigjykim për shkelje procedurale. Ndërsa gjatë procesit gjyqësor administrativ për çregjistrimin e pasurisë, trupi gjykues është kufizuar vetëm në vlerësimin nëse rekursi përmbante ose jo shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58, të ligjit nr. 49/2012.

56. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se vendimet ku ka marrë pjesë gjyqtari A.V. janë marrë në përfundim të proceseve gjyqësore që kanë karakteristika të dallueshme dhe që bazohen në konsiderata e vlerësime të ndryshme të gjyqtarit. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se pjesëmarrja në



trupin gjykues e të njëjtit gjyqtar në dy vendime të dhëna për dy procese të ndryshme, nuk krijon dyshim të justifikuar për mosrespektimin e parimit të gjykimin nga një gjykatë e paanshme nga Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë.

57. Në përfundim, Gjykata çmon se pretendimet e paraqitura nga kërkuessit janë të pabazuara, sipas arsyetimit të mësipërm të këtij vendimi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 11.10.2022.

Shpallur, më 10.11.2022.

Kryetare: Vitore Tusha,

Anëtarë: Elsa Toska, Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Sonila Bejtja, Altin Binaj, Fiona Papajorgji, Ilir Toska

VENDIM

Nr. 25, datë 13.10.2022

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare,
Fiona Papajorgji	anëtare,
Elsa Toska	anëtare,
Altin Binaj	anëtar,
Sonila Bejtja	anëtare,
Sandër Beci	anëtar,
Ilir Toska	anëtar,
Marsida Xhaferllari	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datat 22.9.2022 dhe 13.10.2022 mori në shqyrtim, në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve, çështjen nr. 6 (B) 2022 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Bashkim Dedja, Latif Dedja

SUBJEKT I INTERESUAR:

PROKURORIA E POSAÇME KUNDËR KORRUPTIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 00-2021-815, datë 21.10.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë; nr. 132, datë 1.6.2021, të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 8, datë 20.4.2021, të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 18, pika 1, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “P” dhe 142, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); nenet 27, pikat 1 dhe 2, 71, pika 1, 71/a dhe 71/b, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të kërkuessve, të cilët kërquan pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (Prokuroria e Posaçme), që kërkoj rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme ka regjistruar procedimin penal nr. 137/2020 ndaj kërkuessit Bashkim Dedja (*kërkuessi i parë*), si i dyshuar për veprën penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimi, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi



tjetër që ka detyrimin ligjor për deklaram”, të parashikuar nga neni 257/a, paragrafi 2, i Kodit Penal (KP), të kryer në kohën e ushtrimit të detyrës së gjyqtarit dhe kryetarit të Gjykatës Kushtetuese (Gjykata).

2. Gjatë hetimeve paraprake, Prokuroria e Posaçme, bazuar në ligjin nr. 10192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar (ligji nr. 10192/2009), ka regjistruar procedimin pasuror nr. 4, datë 15.4.2021 ndaj pasurive në zotërim të kërkuarit të parë. Procedimi pasuror u bazua në aktet dhe dokumentacionin e dorëzuar nga kërkuari i parë, në cilësinë e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar sipas nenit 179/b, pika 3, të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

3. Në funksion të hetimit pasuror, Prokuroria e Posaçme ka caktuar ekspert kontabël për llogaritjen e të ardhurave, shpenzimeve familjare dhe aftësisë paguese të kërkuarit të parë dhe ka konstatuar, ndër të tjera, se ai ka zotëruar pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament”, me sipërfaqe 60 m², të ndodhur në Kryemëdhenj, njësi administrative Golem, bashkia Kavajë (pasuria objekt sekuestrimi). Sipas prokurorisë, pasuria ishte regjistruar në emër të vëllait të tij Latif Dedja (kërkuari i dytë), me qëllim fshehjen e saj.

4. Në vijim, në datën 16.4.2021 Prokuroria e Posaçme ka kërkuar në gjykatë vendosjen e masës parandaluese pasurore të sekuestrimit për apartamentin, me argumentin se plotësohen kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin nr. 10192/2009, pasi ajo rrjedh nga veprimtaria kriminale e fshehjes së pasurisë, nuk justifikohet me burime të ligjshme dhe ka rrezik për tjetërsimin e saj. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO-ja e Shkallës së Parë), me vendimin nr. 8, datë 20.4.2021, ka pranuar kërkesën e prokurorisë dhe ka vendosur masën e sekuestrimit, me arsyetimin se ekziston një rrezik real për transferimin ose tjetërsimin e pasurisë të persona të tretë, që do të pamundësonte konfiskimin e saj.

5. Mbi bazën e ankimit të të dy kërkuarëve, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (GJKKO-ja e Apelit), me

vendimin nr. 132, datë 1.6.2021, ka vendosur miratimin e vendimit nr. 8, datë 20.4.2021 të GJKKO-së së Shkallës së Parë me të njëjtin arsyetim. Në këtë vendim ajo është shprehur se “konkluzionet e gjykatës të arritura në këtë fazë, sipas parashikimit të nenit 21 e 22 të ligjit specifik, mund të verifikohen edhe gjatë seancës së konfiskimit. Me fjalë të tjera, ligjvënësi ka parashikuar nëse në procedurën e konfiskimit, në kontradiktoritet të provave të ofruara z. Bashkim Dedja, i cili ka barrën e provës, do të vërtetojë se pasurinë e ka vendosur në mënyrë të ligjshme, i jepet mundësia ligjore të pengojë marrjen e vendimit të konfiskimit, me pasojën e rënies së sekuestros” (shih faqet 15 dhe 16, të vendimit të GJKKO-së së Apelit).

6. Në vijim, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-815, datë 21.10.2021, ka vendosur mospranimin e rekurseve të të dy kërkuarëve, me arsyetimin se ato nuk përmbajnë ndonjë prej shkaqeve të parashikuara në nenin 432, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale (KPP).

7. Në datën 21.2.2022 kërkuarit kanë paraqitur ankim në Gjykatë, duke kërkuar shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të të tria shkallëve, si dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në GJKKO-në e Shkallës së Parë ose në atë të apelit.

8. Me vendimin e datës 12.4.2022, Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve, e cila, me vendimin e datës 4.5.2022, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

9. Prokuroria e Posaçme, krahas prapësimeve për kërkesën objekt gjykimi, ka informuar Gjykatën se kjo prokurori, me shkresën nr. 140 prot. (D.M), datë 22.4.2022, bazuar në ligjin nr. 10192/2009, ka dërguar në GJKKO-në e Shkallës së Parë kërkesën për konfiskimin e pasurisë objekt sekuestrimi në zotërim të kërkuarit të parë, duke bashkëlidhur aktin përkatës.

10. Gjykata në datën 22.9.2022 ka zhvilluar seancën e parë plenare dhe deri në datën 27.9.2022 ka biseduar për marrjen e vendimit, por pa arritur kuorumin e nevojshëm prej 5 anëtarësh. Ndërkohë, ka konstatuar se ekzistonte mundësia për përfshirjen e gjyqtarit Ilir Toska, i cili nuk kishte marrë pjesë në gjykim, pasi kishte filluar detyrën në datën 26.9.2022. Në këto rrethana, Gjykata, bazuar në nenin 73, pika 3, të ligjit nr. 8577/2000 ka vendosur riçeljen e



seancës në datën 13.10.2022 dhe shqyrtimin e çështjes nga e para, me pjesëmarrjen edhe të gjyqtarit të ri.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

11. **Kërkuesit** kanë parashtruar në mënyrë të përmblendhur si më poshtë:

11.1. *Mjetet juridike janë shënuar*, pasi vendimi i sekuestrimit të pasurisë konsiderohet përfundimtar, sepse cenon drejtpërdrejt dhe menjëherë të drejtat e pronës dhe të procesit të rregullt, të mbrojtura nga neni 42 i Kushtetutës, neni 6 i KEDNJ-së, si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të saj. Cenimi i të drejtave themelore ka sjellë rezultat të gabuar të hetimit dhe gjykimit penal, duke rrezikuar deri në pamundësi rivendosjen e këtyre të drejtave në procesin e mëpasshëm penal. Nëse konstatohen këto shkelje, nuk duhet lejuar vazhdimi i proceseve gjyqësore, sepse do të cenoheshin e drejta për proces të rregullt ligjor brenda afatit të arsyeshëm dhe parimi i sigurisë juridike.

11.2. Gjykatat kanë cenuar *të drejtën për një proces të rregullt ligjor*, të garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në aspektet e mëposhtme:

11.2.1. *Parimi i gjykatës së krijuar me ligj*, pasi ato kanë vepruar në kundërshtim me ligjin procedural dhe ligjin e posaçëm. Kërkuesve nuk iu janë njoftuar vendimi për caktimin e ekspertit dhe akti i ekspertimit kontabël, duke iu hequr mundësinë e ushtrimit të të drejtave të tyre.

11.2.2. *Parimi i sigurisë juridike dhe pritsëmërive të ligjshme*, pasi provat vendimtare në dhënien e vendimit gjyqësor janë akte absolutisht të pavlefshme dhe GJKKO-ja e Apelit nuk i shpalli të pavlefshme. Kjo shkelje nuk u riparua as nga Gjykata e Lartë, ndonëse ka në kompetencë kontrollin e gjykatave më të ulëta.

11.2.3. *Parimi i barazisë para ligjit*, pasi Gjykata e Lartë ka vepruar në kundërshtim me praktikën e saj të mëparshme në raste të ngjashme.

11.2.4. *E drejta e mbrojtjes*, pasi GJKKO-ja e Apelit dhe në vijim edhe Gjykata e Lartë nuk pranuan të shqyrtonin provat e paraqitura nga kërkuesit, ndonëse sipas ligjit mbi ta rëndonte barra e provës. Në këtë mënyrë, i gjithë procesi është bazuar vetëm në provat e prokurorisë, duke cenuar për pasojë edhe *të drejtën për t'u dëgjuar*, si dhe *parimet e barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit*.

11.2.5. *Parimi i paanësisë*, pasi GJKKO-ja e Apelit dhe Gjykata e Lartë i kanë dhënë vlerë të paracaktuar kërkimeve dhe provave të prokurorisë.

11.2.6. *E drejta e pronës*, pasi ekzekutimi i menjëhershëm i sekuestrimit të pronës, të vendosur me një proces të parregullt gjyqësor, e ka kaluar atë në administrim të shtetit, duke i shkaktoar pronarit dëm gjer në shkatërrimin e saj.

11.2.7. *E drejta për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtin fakt*, pasi në këndvështrim të jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ), deklaratat dhe përfundimet në procesin disiplinor të rivlerësimit kalimtar lidhur me “fshehjen e apartamentit” përdoren edhe në procesin penal.

12. **Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme**, në mënyrë të përmblendhur, ka prapësuar:

12.1 Kërkuesit *nuk i kanë shënuar të gjitha mjetet juridike efektive* për mbrojtjen e të drejtave të tyre, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, pasi vendimi gjyqësor për sekuestrimin e pasurisë, sipas ligjit nr. 10192/2009, nuk ka natyrë përfundimtare për të drejtat kushtetuese të tyre, pasi procesi nuk ka përfunduar. Kufizimet e pronës janë vendosur për t'i shërbyer interesit publik për parandalimin dhe goditjen e krimeve të rënda përmes sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të personave të dyshuar ose të dënuar për kryerjen e këtyre krimeve.

12.2 Pretendimi i kërkuesve për cenimin e *parimit të gjykatës së caktuar me ligj* nuk qëndron, pasi kërkuesi i parë ka ushtruar detyrën e anëtarit dhe kryetarit të Gjykatës Kushtetuese dhe për këtë shkak ai është subjekt i Prokurorisë së Posaçme, sipas parashikimeve të nenit 75/a, shkronja “ç”, të KPP-së.

12.3 Pretendimi për cenimin e *së drejtës për proces të rregullt ligjor* është i pabazuar. Kërkuesit kanë të drejtë të paraqesin të gjitha provat për të mbrojtur të drejtën e pronësisë gjatë procesit të konfiskimit, i cili ka karakter përfundimtar, në ndryshim nga procesi i sekuestrimit që është urgjent dhe i përkohshëm. Gjatë gjykimit në apel të ankimit nuk mund të merren prova të tjera përveç atyre që i kanë shërbyer gjyqtarit në shkallë të parë për marrjen e vendimit në dhomë këshillimi. Çdo provë të re pala mund ta paraqesë gjatë procesit hetimor përpara prokurorit ose duke paraqitur në gjykatë kërkesë për revokimin e sekuestrimit.



Provat e reja nuk mund të merren *a priori* nga gjykata, pa iu nënshtruar verifikimit paraprak nga prokurori për vërtetësinë e tyre. Po kështu, pretendimi për mosnjohimin e vendimit të ekspertimit duhet rrëzuar, pasi kërkuesi i parë e ka marrë cilësinë e të hetuarit kur ekspertët kanë dorëzuar aktin e ekspertimit. Gjykatat e kanë arsyetuar shumë qartë vendimmarrjen e tyre.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesve

13. Çështja e legjitimitimit të subjekteve që mund t'i drejtohen Gjykatës është një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

14. Gjykata vëren se kërkuesit, si individë, legjitimohen *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “I” dhe 2 të Kushtetutës, pasi kanë qenë palë në procesin gjyqësor gjatë të cilit janë dhënë vendimet e kundërshtuara dhe, për rrjedhojë, kanë interes të drejtpërdrejtë për çështjen.

15. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka funksion përfundimtar dhe, si e tillë, mund të aplikohet vetëm në lidhje me vendime për të cilat kanë përfunduar procedurat gjyqësore. Kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare, që do të thotë se individit duhet t'i ketë shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë

vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtëjshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimet nr. 5, datë 22.2.2022; nr. 14, datë 11.3.2021; nr. 75, datë 22.12.2015 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Gjykata thekson se rregulli për shterimin e mjeteve juridike efektive në dispozicion të individit zbatohet nën dritën e rrethanave të veçanta që paraqet çështja konkrete. Në thelb, ky rregull synon t'u japë organeve publike dhe, në veçanti, gjykatave të juridiksionit të zakonshëm mundësinë të parandalojnë ose korrigjojnë në substancë shkeljet e pretenduara të të drejtave kushtetuese të individit. Për këtë arsye, mjetet juridike në dispozicion të kërkuesit nuk përfshijnë vetëm ankimin kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, por çdo ankim ose kundërshtim, duke u ofruar mundësi organeve publike dhe gjykatave të juridiksionit të zakonshëm të luajnë rolin e tyre subsidiar për t'i garantuar individit mbrojtjen e të drejtave kushtetuese para se ai t'i drejtohet Gjykatës. Ana tjetër e rregullit të shterimit të mjeteve juridike përfshin detyrimin e vetë individit që të tregojë kujdesin dhe vëmendjen e duhur për të paraqitur kërkesa, kundërshtime ose ankime tek organet publike dhe gjykatat e juridiksionit të zakonshëm për rrethanat që mbështesin pretendimet për cenimin e të drejtave kushtetuese.

17. Në çështjen konkrete, Gjykata konstaton se pretendimi i kërkuesve, i paraqitur në parashtimet shtesë të datës 6.6.2022, që lidhet me cenimin e së drejtës për të mos u gjykuar dy herë për të njëjtin fakt, përveçse është parashtuar prej tyre për herë të parë në këtë akt dhe përtej afatit ligjor 4-mujor, është paraqitur drejtpërdrejt përpara Gjykatës, duke mos shteruar paraprakisht mjetet juridike efektive që ata kanë pasur në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se ky pretendim nuk mund të merret në shqyrtim prej saj. Ndërsa për sa u përket pretendimeve të tjera, Gjykata vëren se kërkuesit i kanë parashtuar ato edhe më herët në ankimet e tyre drejtuar gjykatave më të larta të juridiksionit të zakonshëm.

18. Gjykata, bazuar në llojin e procedurës gjyqësore të sekuestrimit të pasurisë, për të konkluduar nëse kërkuesit kanë shteruar mjetet juridike efektive, vlerëson me rëndësi të përcaktojë



nëse ky proces gjyqësor ka natyrë përfundimtare, sipas nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës.

19. Kërkuesit pretendojnë se vendimi për sekuestrimin e pasurisë, për nga natyra dhe pasojat që sjell në të drejtat kushtetuese, është objekt shqyrtimi nga Gjykata, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës. Sipas kërkuesve, në kushtet kur çështja e tyre është gjykuar nga Gjykata e Lartë, vendimi është i pakthyesëm, i pandryshueshëm dhe i pacenueshëm, përveçse me mjete të jashtëzakonshme, sikurse instituti i rishikimit. Vendimi i sekuestrimit të pasurisë, sipas ligjit nr. 10192/2009, cenon drejtpërdrejt të drejtën e pronës të parashikuar dhe të mbrojtur nga neni 42 i Kushtetutës, neni 6 i KEDNJ-së, si dhe neni 1 i protokollit nr. 1 të saj. Procesi i sekuestrimit të pasurisë është një procedurë autonome, i bazuar në indicie, i pavarur nga procedimi penal ose nga rezultatet e tij dhe ekzekutohet menjëherë. Për nga natyra, vendimi i sekuestrimit të pasurisë ngjan dhe ndjek pothuajse të njëjtën “rrugë procedurale” sikurse vendimi për caktimin e masës së sigurimit personal në fushën penale, që cenon lirinë e personit dhe vendimi për sigurimin e padisë në fushën civile, që cenon të drejtën e pronës, të cilat ndonëse konsiderohen si jopërfundimtare, për nga rëndësia e të drejtave që prekin dhe pasojat e drejtpërdrejta dhe të menjëhershme që sjellin, janë konsoliduar tashmë si praktikë gjyqësore nga Gjykata dhe GJEDNJ-ja.

20. Subjekti i interesuar, Prokuroria e Posaçme ka prapësuar se kërkuesit nuk i kanë ezauruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave të tyre, sipas parashikimeve të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, pasi vendimi gjyqësor për sekuestrimin e pasurisë, sipas ligjit nr. 10192/2009 nuk ka natyrë përfundimtare për të drejtat kushtetuese. Kufizimet e pronës janë vendosur për t’i shërbyer interesit publik të parandalimit dhe goditjes së krimeve të rënda përmes sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive të personave të dyshuar ose të dënuar për kryerjen e këtyre krimeve. Sekuestrimi i pasurisë ka si tipar urgjencën e ndërhyrjes dhe përkohshmërinë e zbatimit të masës, pra heqjen e së drejtës së administrimit të pronës për një periudhë të caktuar kohore, ndërsa konfiskimi ka si tipar verifikimin më të thelluar të kërkesës nga ana e gjykatës dhe kalimin përfundimtar të pasurisë në favor të shtetit.

Gjatë kësaj procedure të fundit, kërkuesit kanë të drejtë të administrojnë të gjitha dokumentet që i nënshtrohen shqyrtimit gjyqësor për të mbrojtur të drejtën e tyre të pronësisë.

21. Mbështetur në rrethanat e faktit të çështjes konkrete, Gjykata nuk vë në dyshim karakterin e ndërmjetëm të vendimit të sekuestrimit të pasurisë, në kuptim të rolit që ky vendim luan në procedurën dhe vendimarrjen përfundimtare për konfiskimin e pasurisë. Megjithatë, në raste përjashtimore, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore të ndërmjetme, nëse plotësohen njëherazi tre kushte: i) kur shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm; ii) vendimi i ndërmjetëm të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe gjykatat më të larta të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazi, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; dhe iii) vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimin nr. 14, datë 11.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

22. Gjithashtu, Gjykata është shprehur edhe në lidhje me vendimet gjyqësore për vendosjen e masës së sekuestrimit konservativ ndaj një pasurie të paluajtshme, në kuadër të procedimit penal ende të papërfunduar. Ajo ka vlerësuar se ky lloj vendimi gjyqësor nuk është përfundimtar, pasi masa e sekuestros konservative është një masë sigurimi pasuror, që caktohet me vendim të ndërmjetëm të gjykatës dhe efektet e saj pushojnë kur vendimi i pafajësisë ose i pushimit të çështjes penale ka marrë formë të prerë. Sekuestroja konservative, si masë sigurimi pasuror, është në funksion të procesit penal që zhvillohet ndaj të pandehurit dhe vendosja e saj mund të ankimohet bashkë me vendimin përfundimtar të këtij procesi. Sipas Gjykatës, interesi i kërkuesit buron nga e drejta e pretenduar e pronës, që në vështirim të mjeteve të lejueshme dhe mundësive procedurale që parashikon legjislacioni në fuqi, ai (kërkuesi) ka ende mjete për vendosjen në vend të kësaj të drejte, pasi përveç ankimit bashkë me vendimin përfundimtar, sipas nenit 407 të KPP-së, mund t’u drejtohet gjykatave të juridiksionit të zakonshëm referuar dispozitave



të Kodit Civil (*shih vendimin nr. 48, datë 6.7.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

23. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Gjykata vëren se vendimi i ndërmjetëm për vendosjen e masës së sekuestrimit është bërë objekt i ankimit në GJKKO-në e Apelit dhe i rekursit në Gjykatën e Lartë, të cilat e kanë lënë në fuqi. Për shkak të kësaj mase, kërkuesve u është kufizuar e drejta kushtetuese e pronës, pasi ata nuk mund ta disponojnë lirisht atë. Megjithatë, vendimi i sekuestrimit është i përkohshëm, nuk cenon thelbin e së drejtës së pronës dhe nuk ka natyrë përfundimtare, pasi në çdo kohë kërkuesit mund t'i drejtohen gjykatës së juridiksionit të zakonshëm për revokimin e masës (*shih nenet 12/b dhe 13, të ligjit nr. 10192/2009*). Për më tepër, vendimmarrja për sekuestrimin nuk ka masën e duhur të autonomisë nga procesi i konfiskimit të pasurisë, vendimi i të cilit ka aftësinë të ndryshojë dhe të riparojë në masën e duhur efektet që sekuestrimi ka sjellë. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se në datën 22.4.2022 Prokuroria e Posaçme ka përcjellë në GJKKO-në e Shkallës së Parë kërkesën për konfiskimin e pasurisë objekt sekuestrimi, vlerëson se kërkuesit kanë ende mjete në dispozicion që parimet dhe të drejtat e pretenduara si të cenuara gjatë fazës së sekuestrimit t'i shërojnë nëpërmjet procedurës së konfiskimit, e cila ka natyrë përfundimtare.

24. Në përfundim, Gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar për sekuestrimin e pasurisë nuk konsiderohet përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, për rrjedhojë kërkuesit nuk legjitimohen për paraqitjen e këtij ankimi kushtetues individual.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë, më 13.10.2022.

Shpallur, më 11.11.2022.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Elsa Toska, Fiona Papajorgji, Altin Binaj, Ilir Toska

Anëtarë kundër: Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e ankimit kushtetues individual të paraqitur nga kërkuesit Bashkim Dedja dhe Latif Dedja (*kërkuesit*), me objekt shfuqizimin e vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, të apelit dhe asaj të shkallës së parë (*GJKKO-ja e Apelit dhe GJKKO-ja e Shkallës së Parë*), si të papajtueshme me Kushtetutën, jemi kundër vlerësimit të shumicës se vendimi për sekuestrimin e pasurisë nuk konsiderohet përfundimtar, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000, që parashikojnë publikimin e mendimit të pakicës së bashku me vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese, parashtrojmë në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin kundër.

2. Me të drejtë shumica parashtron se në rastin konkret “nuk vë në dyshim karakterin e ndërmjetëm të vendimit të sekuestrimit të pasurisë, në kuptim të rolit që ky vendim luan në procedurën dhe vendimmarrjen përfundimtare për konfiskimin e pasurisë. Megjithatë, në raste përjashtimore, Gjykata ka përfshirë në juridiksionin kushtetues edhe vendime gjyqësore të ndërmjetme, nëse plotësohen njëheraz tre kushte: i) kur shkelja e pretenduar është pasojë e drejtpërdrejtë e vendimit të ndërmjetëm; ii) vendimi i ndërmjetëm të jetë bërë objekt i ankimit të veçantë dhe gjykatat më të larta të jenë shprehur, qoftë edhe tërthorazë, për të drejtën që pretendohet të jetë cenuar; dhe iii) vendimi i ndërmjetëm duhet të ketë një masë autonomie nga procesi i themelit, në kuptimin që pavarësisht se shqyrtimi gjyqësor i mosmarrëveshjes së themelit vazhdon, vendimi përfundimtar që do të jepet në themel nuk është i aftë të ndryshojë vendimin e ndërmjetëm dhe as të riparojë në masën e duhur efektet që ai ka sjellë (*shih vendimin nr. 14, datë 11.3.2021 të Gjykatës Kushtetuese*)” (*shih paragrafin 21 të vendimit*).



3. Në vijim, shumica analizon rrethanat e faktit të çështjes konkrete dhe vlerëson me të drejtë se dy kushtet e para plotësohen. Ajo që na ndan me shumicën lidhet me analizën e kushtit të tretë “*nëse vendimi i sekuestrimit të pasurisë ka një masë autonomie nga procesi i themelut*”, kusht për të cilin shumica ka vlerësuar se nuk plotësohet, duke arsyetuar shprehimisht se “*vendimi i sekuestrimit është i përkohshëm, nuk cenon thelbin e së drejtës së pronës dhe nuk ka natyrë përfundimtare, pasi në çdo kohë kërkuessit mund t’i drejtohen gjykatës së juridiksionit të zakonshëm për revokimin e masës (shih nenet 12/b dhe 13 të ligjit nr. 10192/2009). Për më tepër, vendimmarrja për sekuestrimin nuk ka masën e duhur të autonomisë nga procesi i konfiskimit të pasurisë, vendimi i të cilit ka aftësinë të ndryshojë dhe të riparojë në masën e duhur efektet që sekuestrimi ka sjellë. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se në datën 22.4.2022 Prokuroria e Posaçme ka përgjellë në GJKKO-në e Shkallës së Parë kërkesën për konfiskimin e pasurisë objekt sekuestrimi, vlerëson se kërkuessit kanë ende mjete në dispozicion që parimet dhe të drejtat e pretenduara si të cenuara gjatë fazës së sekuestrimit t’i shërojnë nëpërmjet procedurës së konfiskimit, e cila ka natyrë përfundimtare*” (shih paragrafin 23 të vendimit).

4. Në themel të këtij arsyeimi janë parashtruar dy argumente se përse masa e sekuestrimit nuk ka masën e duhur të autonomisë nga masa përfundimtare e konfiskimit. Konkretisht, bëhet fjalë, për: i) përkohshmërinë e masës së sekuestrimit; ii) dhe aftësinë e procesit të konfiskimit, që ka natyrë përfundimtare, të shërojë parimet dhe të drejtat që cenohen gjatë fazës së sekuestrimit.

5. Në vlerësimin tonë, përkohshmëria e masës së sekuestrimit nuk përbën argument kushtetues, pasi garantimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nuk lidhet me kohëzgjatjen e ushtrimit të tyre ose të veprimt, që ndërhyt dhe i cenon ato. Kjo do të thotë se Kushtetuta nuk përjashton mbrojtjen e së drejtës kushtetuese, nëse shkelja e saj është e përkohshme. Kushtetuta garanton liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, duke parashikuar parimin themelor se ato janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik (neni 15, pika 1) dhe se organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet t’i respektojnë ato dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre (neni 15, pika 2). Thënë ndryshe, çdo individ lind dhe gëzon të njëjtat të drejta themelore, të cilat janë të

patjetërsueshme, sepse nuk mund t’i hiqen individit; asnjëra prej tyre nuk mund të gëzohet pa të tjerat, sepse janë të pandashme; ato duhet të garantohen nga mekanizmat mbrojtës të pushtetit publik, sepse janë të padhunueshme; mbrojtja e tyre është detyrë e shtetit të së drejtës. Për shkak të këtyre karakteristikave, Kushtetuta parashikon përgjegjësitë konkrete të pushtetit publik për realizimin e tyre, si dhe mekanizmat mbrojtës për shkeljet eventuale, ku përfshihet edhe ankimi kushtetues individual.

6. Duke vijuar këtë linjë arsyeimi, duhet theksuar se vendimi i sekuestrimit ndërhyt përkohësisht në të drejtën kushtetuese të pronës private. Kjo ndërhyrje, si rregull, zgjat për aq kohë sa zhvillohet procedimi pasuror deri në dhënien e vendimit përfundimtar për konfiskimin e pasurisë. Në çështjen konkrete, kërkesa e Prokurorisë së Posaçme për sekuestrimin e pasurisë është pranuar nga GJKKO-ja e Shkallës së Parë në datën 20.4.2021 dhe në kohën e shqyrtimit të çështjes në Gjykatë, më 13.10.2022, procedimi pasuror gjendej në fazën e gjykimit të kërkesës për konfiskim në gjykatën e shkallës së parë. Këto të dhëna tregojnë se ndërhyrja në të drejtën e pronës ka vazhduar për rreth 1 vit e 6 muaj dhe është e pritshme të zgjasë, duke mbajtur në konsideratë edhe kohën e duhur për përfundimin e procesit gjyqësor të konfiskimit, përfshirë shqyrtimin eventuale të ankimeve në gjykatat më të larta. Në këtë këndvështrim, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, bazuar në nenet 15 dhe 42 të Kushtetutës, kanë detyrimin kushtetues të respektojnë dhe të kontribuojnë për realizimin e të drejtave kushtetuese individuale, që do të thotë se vendimi për një masë të tillë, që kufizon të drejtën e pronës, duhet të jepet në përputhje me standardet e procesit të rregullt ligjor dhe gjykimi nuk duhet të jetë arbitrar.

7. Për sa më lart, argumenti për natyrën e përkohshme të masës së sekuestrimit, i përdorur për ta përjashtuar vendimin e sekuestrimit nga kontrolli kushtetues, rrezikon qartazi të mohojë mekanizmin kushtetues për mbrojtjen e të drejtave themelore. Për më tepër, përkohshmëria duket se nuk është vlerësuar edhe nga vetë Gjykata si element përcaktues në këto raste, pasi ajo ka pranuar juridiksionin e saj për kontrollin e vendimeve gjyqësore të masave të sigurimit personal “arrest në burg”, të cilat, gjithashtu, janë vendime jopërfundimtare, të përkohshme dhe që



mund të revokohen ose ndryshohen përgjatë procedimit penal gjer në dhënien e vendimit përfundimtar për fajësinë e të pandehurit (*shih vendimin nr. 28, datë 23.6.2011, të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Nën këtë analizë, elementi që duhej analizuar dhe është përcaktues për zgjidhjen e kësaj çështjeje lidhet me masën e autonomisë që vendimi i ndërmjetëm i sekuestrimit ka ndaj vendimit përfundimtar të konfiskimit.

9. Në parim duhet theksuar se Gjykata është treguar e kujdesshme kur ka zhvilluar jurisprudencën për kushtet përjashtimore të përfshirjes në juridiksionin e saj të vendimeve të ndërmjetme dhe për kushtin që u debatua në këtë gjykim është shprehur saktësisht se duhet që “vendimi i ndërmjetëm të ketë një masë autonomie nga procesi i themeli” (*shih paragrafin 33, të vendimit nr. 14, datë 11.3.2021, të Gjykatës Kushtetuese*). Pra, bëhet fjalë për “një masë autonomie” dhe jo autonomi të plotë, gjë që përputhet me natyrën e vendimit të ndërmjetëm, i cili në çdo rast jepet nga gjykata brenda dhe në funksion të procesit që zgjidh mosmarrëveshjen gjyqësore me vendim përfundimtar. Në këtë mënyrë, e domosdoshme për plotësimin e kushtit në fjalë mbetet aftësia që vendimi përfundimtar ka për të riparuar efektet e vendimit të ndërmjetëm, në kuptimin që nëse vendimi përfundimtar kontrollon dhe rivendos të drejtën e shkelur nga vendimi i ndërmjetëm, atëherë ky i fundit nuk ka masën e duhur të autonomisë për qëllime të juridiksionit kushtetues.

10. Duke u kthyer te vendimi i sekuestrimit, konstatohet se ai ka lidhje organike funksionale me vendimin përfundimtar të konfiskimit, meqë masa e sekuestrimit vendoset për të garantuar suksesin e ekzekutimit të konfiskimit. Rrjedhimisht, për të përcaktuar masën e autonomisë, pra se sa i aftë është vendimi i konfiskimit të riparojë efektet e shkeljeve eventuale të shkaktuara nga vendimi i sekuestrimit, merr rëndësi të analizohen objektet e gjykimeve të sekuestrimit dhe të konfiskimit.

11. Duke vijuar analizën në këtë drejtim, vihet re se objekti i gjykimit të sekuestrimit është mbledhja e fakteve dhe zbatimi i neneve 11–14, të ligjit nr. 10192/2009, për të nxjerrë përfundimin nëse ka dyshime të arsyeshme që pasuria, për të cilën ka filluar procedimi pasuror i konfiskimit, mund të tjetërsohet, shpërndahet, transferohet, shpërdorohet, fshihet ose zhvlerësohet. Ndërsa objekti i gjykimit të konfiskimit është mbledhja e

fakteve dhe zbatimi i neneve 21–25 të ligjit nr. 10192/2009 për të nxjerrë përfundimin nëse burimi i pasurisë (së sekuestruar ose jo) është rrjedhojë e veprimtarisë së krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera. Thënë këtë, është e qartë se vendimi përfundimtar i konfiskimit disponon në mënyrë përfundimtare për pasurinë, e cila mund të jetë sekuestruar ose jo, por në gjykimin e konfiskimit nuk kontrollohet më rregullsia e procesit të zhvilluar për sekuestrimin dhe drejtësia e masës së sekuestrimit, një gjë e tillë është tërësisht e përjashtuar nga objekti i gjykimit të konfiskimit. E njëjta gjë ndodh edhe me ankimin eventual që individit mund të bëjë në gjykatat më të larta kundër vendimit të konfiskimit. Në një situatë të tillë, nëse individit në ankimin kundër masës së konfiskimit ngre shkaqe për parregullsitë e procesit të sekuestrimit, ato janë të papranueshme, pasi kanë qenë objekt verifikimi i procesit të sekuestrimit, për të cilin ligjvënësi ka parashikuar ankim të veçantë gjer në Gjykatën e Lartë.

12. Edhe alternativa që individit mund t'i drejtohet sërish gjykatës me kërkesa për revokim të sekuestrimit, nuk do të thotë që gjykata me vendimin e revokimit riparon efektet e një procesi eventual të parregullt sekuestrimi, por verifikon nëse kanë rënë kushtet e sekuestrimit në kohën që paraqitet kërkesa për revokim. Me fjalë të tjera, vendimi i revokimit të sekuestrimit ose vendimi përfundimtar i konfiskimit në alternativën më të favorshme (*in meus*) për individin ndalon shkeljen e mëtejshme të së drejtës kushtetuese të pronës së tij, por nuk është i aftë të riparojë shkeljet eventuale në drejtim të kufizimit të kësaj të drejte që kanë ndodhur në procesin gjyqësor të sekuestrimit.

13. Si përfundim, në përmbledhje të argumenteve të mësipërme, vlerësojmë se vendimi i sekuestrimit ka masën e duhur të autonomisë nga vendimi përfundimtar i konfiskimit dhe se vendimet gjyqësore që kanë disponuar për masën e sekuestrimit për pasuritë e individit, bazuar në ligjin nr. 10192/2009, duhet t'i nënshtrohen kontrollit kushtetues, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës.

14. Për të gjitha arsyet e mësipërme, ne, gjyqtarët në pakicë, çmojmë se ankimi kushtetues



kishte në objektin e tij një vendim përfundimtar dhe se Gjykata duhet të shqyrtonte dhe të vendoste për themelin e pretendimeve të kërkuarve.

Anëtarë: Sandër Beci, Sonila Bejtja, Marsida Xhaferllari

VENDIM

Nr. 271, datë 27.10.2022

MBI KËRKESËN E DEPUTETES ZNJ. JORIDA TABAKU PËR RISHIKIMIN DHE PEZULLIMIN E EKZEKUTIMIT TË VENDIMIT TË BORDIT TË ERE-S NR. 242, DATË 23.9.2022, “MBI KËRKESËN E SHOQËRISË FSHU SHA, LIDHUR ME KOSTOT QË DUHET TË PËRFSHIHEN NË LLOGARITJEN E ÇMIMIT ME PAKICË TË ENERGJISË PËR KLIENTËT FAMILJARË ME KONSUM MBI 800 KWH NË MUAJ”

Në mbështetje të nenit 1, 16, pika 5, 83, 85 dhe nenit 90, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 33, pika 2, dhe nenit 180, pika 1, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 584, datë 8.10.2021, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, të ndryshuar; VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; “Metodologjisë së Përcaktimit të Çmimeve për Shitjen e Energjisë Elektrike me Pakicë të Klientët Fundorë që Furnizohen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU)”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 189, datë 23.11.2017; nenit 5, pika 23, nenit 15 dhe nenit 16 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.10.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1829/2 prot., datë 19.10.2022, të përgatitur nga Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve “Mbi kërkesën e deputetes znj. Jorida

Tabaku për rishikimin dhe pezullimin e vendimit nr. 242, datë 23.9.2022, të bordit të ERE-s, ‘Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a. lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kwh në muaj”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 242, datë 23.9.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a. lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kwh në muaj”, vendosi ndër të tjera miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike prej 42 lekë/kwh për konsumin mbi 800 kwh/muaj për klientët familjarë për periudhën 1 tetor–31 dhjetor 2022.

- Më datë 30.9.2022, nëpërmjet postës elektronike, ERE u bë me dije mbi kërkesën e deputetes së Kuvendit të Shqipërisë znj. Jorida Tabaku për rishikimin e vendimit nr. 242/2022 të Bordit të ERE-s, kërkesë kjo e cila është formalizuar me shkresën e Sekretarit të Përgjithshëm të Kuvendit (e cila ka përcjell kërkesën e deputetes znj. Jorida Tabaku) nr. 3248 prot., datë 3.10.2022, protokolluar në ERE me nr. 1610/6 prot., datë 4.10.2022. Në këtë shkresë argumentohet, se:

- Nisur nga deklarata e Kryeministrit në rrjetin social *Facebook* dhe në dritën e fakteve të reja sa i përket situatës në sektorin energjetik, në cilësinë e deputetes së Kuvendit të Shqipërisë, është kërkuar thirrja e një mbledhje urgjente të Bordit të ERE-s, për të rishikuar vendimin nr. 242, datë 23.9.2022.

- Në kushtet kur është depozituar një kërkesë për rishikimin e vendimit nr. 242, datë 23.9.2022, për të cilën Bordi duhet të shprehet me vendim brenda një afati 30-ditor, nga ana e kërkuarës vlerësohet se plotësohen kushtet kur mund të lejohet marrja e masës për pezullimin e vendimit deri në përfundimin e shqyrtimit të kësaj kërkesë.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, ka parashikuar në nenin 16, pika 5, se: “çdo palë e përfshirë në një procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit lidhur me atë procedurë, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabimet materiale të konstatuara”.



Për sa përcaktuar në nenin 5, pika 23, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 96, datë 3.9.2016, si dhe në nenin 33, pika 2, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, deputetja e Kuvendit të Shqipërisë, znj. Jorida Tabaku, legjitimohet si palë e përfshirë/e interesuar në procedurën e materializuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 242, datë 23.9.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kwh në muaj”, për vetë rolin e rëndësishëm që Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë i ka dhënë funksionit të deputetit në nenin 70, pika 1, si përfaqësues të popullit. Gjithashtu, pala kërkuuese rezulton se është brenda afateve ligjore për të kërkuar anulimin dhe pezullimin e vendimmarrjes së ERE-s.

- Pikat 4 dhe 5, të nenit 16, të “Rregullores së sipërcituar, njohin të drejtën e Bordit të ERE-s për të pezulluar aktin e miratuar nga vetë ai, sipas një kërkesë të paraqitur nga një subjekt i interesuar, përveç rasteve kur: 1. Pezullimi i aktit ndalohet me ligj dhe 2. Zbatimi i menjëhershëm i tij është në interes publik.

- Gjithashtu, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 180, pika 1 ka parashikuar, se: “ekzekutimi i detyrueshëm pezullohet kryesisht ose me kërkesë të subjektit të ekzekutimit në rastet kur: a) vërtetohet se ekziston rreziku i shkakut të një dëmi të rëndë dhe të pazëvendësueshëm për subjektin e ekzekutimit dhe pezullimi në këtë rast nuk e cenon interesin publik”. Lidhur me këtë dispozitë të Kodit sqarojmë se pala kërkuuese nuk jep asnjë shpjegim lidhur me dëmin e rëndë dhe të pazëvendësueshëm që do t’iu vijë klientëve familjarë, ndërkohë që kërkesa e paraqitur nga shoqëria FSHU sh.a., mbi nevojën e përballimit të kostove shtesë për blerjen e energjisë elektrike, përbën interes të lartë publik, në kuadër të garantimit të furnizimit me energji elektrike dhe të menaxhimit të situatës së krizës energjetike, për të cilën Këshilli i Ministrave ka shpallur gjendjen e emergjencës, si dhe është e mbështetur në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, i cili përcakton se qëllimi kryesor i tij

është garantimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe të sigurt me energji elektrike të klientëve fundorë.

- Sa më sipër, vlerësohet se argumentimi i palës kërkuuese nuk ka përmbushur kushtin e parashikuar në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, për sa i përket sigurimit të një prove të re, e cila mund të çonte Bordin në një vendimmarrje ndryshe dhe as kushtin e ekzistencës së rrezikut të shkakut të dëmit të rëndë dhe të pazëvendësueshëm.

- Gjithashtu, kërkesa për pezullimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 242/2022, e ka humbur aktualitetin pasi Bordi i ERE-s është shprehur për rishikimin e tij me vendimin nr. 254, datë 7.10.2022, “Mbi një ndryshim në vendimin nr. 242, datë 23.9.2022, të Bordit të ERE-s mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kwh në muaj”, me të cilin u vendos ndryshimi i pikës 1, të vendimit nr. 242, datë 23.9.2022, si dhe lënia në fuqi e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike të FSHU sh.a., për konsumatorët familjarë, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 74, datë 13.4.2022, për muajin tetor 2022.

- Për sa më sipër, kërkesa për anulimin e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 242/2022, nuk mund të pranohet për sa kohë ky vendim reflekton vendimin nr. 6490/5 prot., datë 5.10.2022, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit, “Për pezullimin e aplikimit të tarifave të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a., për muajin tetor 2022”, vendim i cili vazhdon të mbetet në fuqi, dhe nëse do të ketë ndryshime, ERE do të rivlerësojë kostot e FSHU sh.a., bazuar në legjislacionin në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Refuzimin e kërkesës së deputetes znj. Jorida Tabaku për rishikimin dhe pezullimin e ekzekutimit të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 242, datë 23.9.2022, “Mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për



klientët familjarë me konsum mbi 800 kwh në muaj”.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palën e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 272, datë 27.10.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE (RREGULLAT E ALPEX PËRKUFIZIMET, PROCEDURA E TREGTIMIT, SI DHE PROCEDURA E KIERIMIT DHE E SHLYERJES)

Në mbështetje të nenit 16, nenit 19, pika “a” dhe nenit 98, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, si dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregulator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga drejtoritë teknike, me nr. 1829 prot., datë 17.10.2022, “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së ALPEX sh.a. dhe të OST sh.a., për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e ALPEX përkufizimet, procedura e tregtimit, si dhe procedura e kërimit dhe e shlyerjes), si dhe anulimin e rregullave të tregtimit, termat e përgjithshëm, miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 214, datë 28.12.2017”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 214, datë 28.12.2017, vendosi miratimin e “Rregullave të tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe marrëveshjes së pjesëmarrjes në Bursën Shqiptare të Energjisë”, ku në pikën 2, të vendimit, është përcaktuar, se: “Këto rregulla do të hyjnë në fuqi me bërjen të zbatueshëm të modelit të tregut, në momentin e fillimit të punës së Bursës Shqiptare të Energjisë, siç parashikuar në pikën 8, të VKM-së nr. 519, datë 13.7.2016”.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 519, datë 13.7.2016, “Për miratimin e modelit të tregut të energjisë elektrike”, në pikën 8 përcakton, se: “Modeli i tregut të organizuar, siç është përcaktuar në këtë tekst, do të jetë i aplikueshëm në momentin e fillimit të punës së Bursës Shqiptare të Energjisë.

- ALPEX sh.a., me fillimin e vitit 2021 nisi punë për përgatitjen e termave të referencës për përzgjedhjen e ofruesit të shërbimit me asistencën e USAID-it. Në fund të vitit 2021 u arrit përzgjedhja e ofruesit të shërbimit me fitues bashkimin e operatorëve të udhëhequr nga Bursa e Athinës “Hellenic Exchanges – Athens Stock Exchange S.A.”, Grupi i Bursës së Energjisë Elektrike të Greqisë, me dy kompanitë e saj “Hellenic Energy Exchange S.A.” dhe “Enex Clearing House S.A.”.

- ALPEX sh.a., duke përfutur dhe nga eksperiencia e ofruesit të shërbimit, me shkresën nr. 201 prot., datë 29.8.2022, ka paraqitur në ERE: Propozim për anulimin e dokumentit “Rregullat e Tregtimit – Termat e përgjithshëm”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 214, datë 28.12.2017, dhe miratimin e dokumenteve që përbëjnë tërësinë e rregullave qeverisëse të ALPEX sh.a.”.

- Në shkresën nr. 201 prot., datë 29.8.2022, ALPEX sh.a., bën me dije, se faza parapërgatitore e këtyre dokumenteve ka qenë e gjatë dhe shumë përfshirëse. Gjatë kësaj periudhe për bërjen funksionale të Bursës Shqiptare të Energjisë Elektrike, ALPEX sh.a. ka pasur konsultime të vazhdueshme me palët e interesit, si: pjesëtarët e tregut të energjisë, konsulentët e ALPEX-it, konsulentët për reformën në sektorin e energjisë pranë Ministrisë së infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe ofruesin e shërbimit të ALPEX-it.

- Në këtë proces konsultimi është evidentuar nevoja për të rishikuar rregullat ekzistuese të



tregtimit dhe për të akomoduar të gjitha zhvillimet që tregu i organizuar i energjisë elektrike me shumicë ka pësuar në vendet e bashkimit evropian, si për çështje rregullatore, ashtu dhe ato teknike. Nga konsulenca me palët e sipërpërmendura u arrit në konkluzion për nevojën e hartimit të një grupi të ri rregullash, të cilat reflektojnë ndryshimet e tregut, si dhe përshtatin më së miri modelin që ofruesi i shërbimit ka zbatuar në tregun e tij, në përputhje kjo edhe me modelin e Operimit të Sistemit të Transmetimit (OST) të energjisë elektrike në Shqipëri.

- Zhvillimet e lartpërmendura kanë diktuar kërkesën për të rishikuar edhe modelin ekzistues të tregut të energjisë elektrike, konkretisht në pjesët që kanë lidhje me bursën dhe, për këtë qëllim, ALPEX sh.a. bën me dije se me anë të shkresës nr. 179 prot., datë 2.8.2022, ka dërguar pranë MIE-s kërkesën për disa ndryshime të VKM-së nr. 519, datë 13.7.2016.

- Në kuadër të konsultimit me palët e interesuara, ALPEX-i bën me dije se i publikoi këto rregulla dhe procedura në faqen zyrtare të *web-it*, si dhe i dërgoi ato në adresat e postës elektronike të të gjithë pjesëtarëve të tregut të energjisë dhe bankave kryesore të sistemit bankar. Qëllimi i konsultimit publik ishte marrja në konsideratë dhe akomodimi i nevojave të pjesëtarëve të tregut, për sa u përket rregullave qeverisëse të zhvilluara nga ALPEX-i.

- Në vijim, OST sh.a., nëpërmjet shkresës nr. 5872 prot., datë 26.9.2022, me lëndë “Mbi miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (rregullat e ALPEX përkufizimet, procedura e tregtimit, si dhe procedura e kërimit dhe të shlyerjes)”, mbështet propozimin e bërë nga shoqëria ALPEX, për: anulimin e dokumentit Rregullat e Tregtimit – Termat e përgjithshëm, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 214, datë 28.12.2017, dhe miratimin e dokumenteve që përbëjnë tërësinë e rregullave qeverisëse të ALPEX sh.a.

- OST sh.a. i gjen propozimet e ALPEX sh.a. të mbështetura në ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike miratuar me VKM-në nr. 519, datë 13.7.2016, Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 106, datë 2.7.2020 dhe Rregullat e Ankandit të SEE CAO-s, të cilat

janë miratuar nga Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 197, datë 26.11.2020, “Mbi miratimin e rregullave të harmonizuara të alokimit të kapaciteteve të interkonjeksionit për Zyrën e Koordinimit të ankandeve në Evropën Juglindore (SEE CAO) për kufijtë Shqipëri–Greqi, Shqipëri–Mali Zi dhe Shqipëri–Kosovë”.

- OST sh.a. ka miratuar propozimet e ALPEX sh.a. nëpërmjet votës së anëtarëve në Këshillin Mbikëqyrës të ALPEX sh.a., të caktuar nga OST sh.a. në cilësinë e aksionarit të ALPEX sh.a., me vendimin nr. 4, datë 25.8.2022, “Për miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (rregullat e ALPEX përkufizime, procedurat e tregtimit, si dhe procedura e kërimit dhe e shlyerjes)”

- OST sh.a., në cilësinë e aksionarit të ALPEX sh.a., kërkon miratimin e propozimit për Rregullat e Tregut të Energjisë Elektrike (rregullat e ALPEX përkufizimet, procedura e tregtimit, si dhe procedura e kërimit dhe e shlyerjes), pasi këto rregulla përbëjnë një hap shumë të rëndësishëm për ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit të ndërmarrë nga ALPEX sh.a. për bërjen efektive dhe vënien në operim të Bursës Shqiptare të Energjisë elektrike, sa më shpejt.

- ALPEX sh.a., me shkresën nr. 201 prot., datë 29.8.2022, bën me dije se ka përmbyllur fazën e konsultimeve dhe draftimin e dokumenteve, variantet finale të të cilave i ka përcjellë në ERE me shkresën e sipërcituar për shqyrtim. Këto drafte dokumentacioni vlerësohen të publikohen për të vijuar me procesin e konsultimit publik me palët e interesit.

- Në mbledhjen e Bordit të ERE-s, datë 27.10.2022, ishte pjesëmarrës edhe z. S.S., përfaqësues i Shoqatës Shqiptare të Furnizuesve të Energjisë dhe shprehu dakordësinë mbi fillimin e procedurave për miratimin e tyre dhe kryerjen e konsultimeve publike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës, “Për miratimin e rregullave të tregut të energjisë elektrike (rregullat e ALPEX përkufizimet, procedura e tregtimit, si dhe procedura e kërimit dhe e shlyerjes).

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë palët e interesit, si



dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, ALPEX sh.a., OST sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 273, datë 27.10.2022

**MBI RISHIKIMIN E KONTRATËS
NDËRMJET SHOQËRIVE KESH SHA
DHE FTL SHA, PËR PERIU DHËN
KOHORE 1.1.2022 DERI MË 31.12.2022**

Në zbatim të neneve 16, 20, germa "h", 47, 56, germa "P", si dhe 90, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar; pjesës I, nenit 4, pikës 7, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike"; VKM-së nr. 650, datë 10.10.2022, "Për disa ndryshime në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, 'Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike'; kapitullit V, të "Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike", miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 139, datë 15.8.2016, të ndryshuar; "Kodi i Transmetimit", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 63, datë 11.4.2022, si dhe nenit 15 të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i

ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.10.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1829/3 prot., datë 21.10.2022, të përgatitur nga drejtoritë teknike "Mbi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe furnizuesi i shërbimit universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a., për periudhën kohore 1.1.2022 deri më 31.12.2022",

konstatoi se:

- Me shkresën e përbashkët nr. 4844/1 prot., datë 30.9.2022 shoqëritë KESH sh.a. dhe FTL sh.a. kanë dërguar në ERE kërkesën për miratimin e kontratës me nr. 2473 prot., datë 30.9.2022 (FTL sh.a.) dhe nr. 4844 prot., datë 30.9.2022 (KESH sh.a.), të miratuar dhe nënshkruar ndërmjet palëve FTL sh.a. dhe KESH sh.a.

- Baza ligjore e referuar në kontratë është:

- Ligji nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar;

- Vendimi nr. 456, data 29.6.2022, i Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike";

- VKM-ja nr. 584, datë 8.10.2021, "Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike", i ndryshuar;

- Rregullat e Përkohshme të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin nr. 139/2016, të Bordit të ERE-s, të ndryshuar;

- Vendimi nr. 23, datë 25.3.2009, të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, "Mbi rinovimin e licencave në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a.", të ndryshuar;

- Vendimi nr. 198, datë 3.9.2018, i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë "Mbi licencimin e Shoqërisë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a., (FTL sh.a.) në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike";

- Vendimi nr. 253, datë 21.12.2021, i Bordit të ERE-s, "Mbi çmimin vjetor të blerjes së energjisë elektrike që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2022".



- Palët, respektivisht KESH sh.a. dhe FTL sh.a., kanë referuar si bazë ligjore në kontratë, VKM-në nr. 456, datë 29.6.2022. Kjo reference ligjore është e saktë, por e paplotë, pasi kjo VKM shtrin efektet nga data 29.6.2022 e në vijim, ndërkohë kontrata e referuar në ERE shtrin efektet për periudhën 1.1.2022–31.12.2022.

- Në pikën 2, të VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, rezulton se VKM-ja nr. 244/2016 dhe VKM-ja nr. 620/2021, të ndryshuara, shfuqizohen. Për periudhën 1 janar 2022 e deri në momentin e hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, marrëdhëniet ndërmjet palëve janë rregulluar bazuar në VKM-në nr. 620, datë 22.10.2021, “Për miratimin e kushteve, për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe për përballimin e parandalimin e saj, ndryshuar me VKM-në nr. 757, datë 9.12.2021. Në këtë kontekst, Palët duhet të rishikojnë kontratën e nënshkruar ndërmjet tyre, duke marrë në konsideratë VKM-të e sipërcituara dhe periudhat për të cilat ato kanë efekte juridike. Pasi për periudhën 1.1.2022–31.12.2022, VKM-të kanë fuqi juridike për pjesë të ndryshme të vitit.

- Neni 12, pika 4, të VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, parashikon trajtimin e tepricave të energjisë elektrike të krijuara nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë, të cilat depozitohen te shoqëria publike e prodhimit, për t’u përdorur për nevoja të furnizimit dhe shkëmbehen gjatë vitit për mbulimin e humbjeve të OSSH sh.a. deri në mbulimin e plotë të tyre.

- Në nenin 5, pika 7, të VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, parashikohet trajtim i tepricave të prodhimit të energjisë elektrike nga shoqëria publike, për qëllim të mbulimit të humbjeve në rrjetin e shpërndarjes së OSSH sh.a. Në këto kushte, palët kanë lidhur dhe nënshkruar këtë kontratë për shitblerje/depozitimin/shkëmbimin e energjisë elektrike, me qëllim plotësimin e kërkesës me sasi energjie elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, sipas rasteve të mëposhtme:

- KESH sh.a., në rolin e “shitësit” dhe FTL sh.a. në rolin e “blerësit”: Për atë sasi të energjisë elektrike që evidentohet si tepricë e energjisë elektrike mbas mbylljes së bilancit që ka pasur destinacion plotësimin e kërkesës për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2022–31.12.2022.

- FTL sh.a., në rolin e “depozitdhënësit” dhe KESH sh.a., në rolin e “depozituesit”, për atë sasi të energjisë elektrike e evidentuar si tepricë të energjisë elektrike nga prodhimi i burimeve të rinovueshme të energjisë. Kjo sasi e energjisë elektrike e depozituar do t’i kthehet – shkëmbehet shoqërisë FTL sh.a. për plotësimin e kërkesës për humbjet në rrjetin e shpërndarjes brenda vitit kalendarik.

- FTL sh.a., në rolin e “shitësit” dhe KESH sh.a., në rolin e “blerësit”, për atë sasi të energjisë elektrike, e cila evidentohet në fund të vitit kalendarik, e pakompensuar me energji elektrike për mbulimin e humbjeve, dhe ku FTL-ja ia shet KESH sh.a., me çmimin e blerjes së energjisë elektrike nga prodhuesit me përparësi hidrike.

- Sasitë e energjisë të shitura / blera / depozituara/shkëmbyera, në zbatim të parashikimeve të pikës 2 të nenit 15 të VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, rakordohen mes palëve bazuar në të dhënat faktike. Në procesin e rakordimit, sasia e energjisë elektrike e depozituar do të jetë ajo sasi e energjisë elektrike e prodhuar nga burimet e rinovueshme të energjisë përtej sasisë së alokuar për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes.

- Në kontratë, në nenin 2, përcaktohen edhe të drejtat e detyrimit e palëve, ku:

- FTL sh.a., përpara çeljes së procedurës së blerjes në treg të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, do të konfirmojë me shoqërinë KESH sh.a., sasitë gjendje të energjisë elektrike të depozituara, si dhe do të informojë KESH sh.a., për sasinë që ka planifikuar të blejë për mbulimin e humbjeve në rrjet, duke i kërkuar KESH sh.a. informacion mbi mundësinë që kjo e fundit ka për ta furnizuar me sasi energjie elektrike nga prodhimi i kaskadës.

- KESH sh.a., në funksion të kapacitetit gjenerues (në rast prurjesh në kaskadë) përpara çeljes së procedurave të shitjes së energjisë elektrike, njofton shoqërinë FTL sh.a. mbi mundësinë e prodhimit të energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes,



ndërsa kjo e fundit duhet të konfirmojë brenda afatit të përcaktuar në kërkesën e KESH-it pranimin ose jo të sasisë së energjisë elektrike të ofruar nga KESH sh.a. për mbulimin e humbjeve.

- Në këtë kontratë përcaktohen edhe të drejtat e detyrimit të shitësit ku përcaktohet qartë në nenin 5, se shitësi, bazuar në programe vjetore / mujore / javore/ditore në *day-ahead* dhe *intra-day* do të sigurojë përmbushjen e kërkesës së blerësit.

- Në kontratë janë trajtuar dhe shumë elemente të tjera, me rëndësi për mirë funksionimin e një marrëdhënie kontraktuale midis palëve. Si të tillë në kontratë janë përcaktuar modalitetet që kanë të bëjnë me: faturimin dhe kushtet e pagesave, po ashtu janë trajtuar aspekte të mos performacës për shkak të forcës madhore apo pamjaftueshërisë së plotësisht të kërkesës për klientët universalë, personat e palëve përfaqësuese në këtë kontratë, si dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve.

- Aneksi 1 i kësaj kontrate paraqet akt rakordimin për energjinë elektrike të depozituar dhe shkëmbyer midis palëve në këtë kontratë, për periudhën janar–gusht 2022.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. KESH sh.a. dhe FTL sh.a. të rishikojnë kontratën e përcjellë në ERE, bazën ligjore dhe nenin 8 të kontratës ndërmjet shoqërisë KESH sh.a. dhe shoqërisë FTL sh.a., për periudhën kohore 1.1.2022–31.12.2022.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë të shoqëritë KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 274, datë 27.10.2022

**MBI RISHIKIMIN E KONTRATËS TIP
PËR SHITBLERJEN E ENERGJISË
ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË
SË PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE TË NGARKUAR ME
DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK,
AKSIONET E SË CILËS
KONTROLLOHEN, PLOTËSISHT OSE
PJESËRISHT NGA SHTETI, KESH SHA
DHE FURNIZUESI I SHËRBIMIT
UNIVERSAL (FSHU) SHA, PËR
FURNIZIMIN E KLIENTËVE QË
FURNIZOHEN NGA FSHU SHA,
PËR PERIUDHËN KOHORE 1.1.2022
DERI MË 31.12.2022**

Në zbatim të neneve 16, 20, germa “h”, 47, 56, germa “p”, si dhe 90, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; pjesës I, nenit 4, pikës 7, të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.6.2022, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; VKM-së nr. 650, datë 10.10.2022, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 584, datë 8.10.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”; kapitullit V, të “Rregullat e Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 139, datë 15.8.2016, të ndryshuar; “Kodi i Transmetimit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 63, datë 11.4.2022, si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.10.2022, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1829/4-1 prot., datë 26.10.2022, të përgatitur nga drejtoritë teknike “Mbi miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe



furnizuesi i shërbimit universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a., për periudhën kohore 1.1.2022 deri më 31.12.2022”,

konstatoi se:

- Me shkresën e përbashkët nr. 4845/1 prot., datë 30.9.2022, shoqëritë KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. kanë dërguar në ERE kërkesën për miratimin e kontratës me nr. 4670 prot., datë 30.9.2022, (FSHU sh.a.) dhe nr. 6926 prot., datë 30.9.2022 (KESH sh.a.), të miratuar dhe nënshkruar ndërmjet palëve FSHU sh.a. dhe KESH sh.a.

- Baza ligjore e referuar në këtë kontratë është:

- Neni 20, germa “h”, e ligjit nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar;

- Vendimi nr. 456, datë 29.6.2022, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”;

- Vendimi nr. 584, datë 8.10.2021, i Këshillit të Ministrave, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”, të ndryshuar;

- Vendimi nr. 23, datë 25.3.2009, i Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, “Mbi rinovimin e licencave në aktivitetin e prodhimit dhe tregtimit të energjisë elektrike shoqërisë KESH sh.a.”, i ndryshuar;

- Vendimi i Bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016, “Për përcaktimin e të licencuarit të ngarkuar me detyrimin e shërbimit universal për tregun e energjisë elektrike dhe përcaktimin e kushteve për ushtrimin e detyrimit të shërbimit universal”;

- Vendimi nr. 215, datë 11.10.2018, i Bordit të ERE-s, “Mbi transferimin e licencës së furnizimit të energjisë elektrike me nr. 251, me seri P14FPP, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 97, datë 27.10.2014, e vlefshme deri më datë 27.10.2019 dhe detyrimit të shërbimit universal të furnizimit të energjisë elektrike, të shoqërisë Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike sh.a. (OSHEE sh.a.), miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 112, datë 8.7.2016, të shoqëria “Furnizuesi i Shërbimit Universal” sh.a. (FSHU sh.a.)”, i ndryshuar;

- Vendimi nr. 164, datë 4.11.2019, i Bordit të ERE-s, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a.), në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”;

- Vendimi i ministrit përgjegjës për energjinë nr. 1394/1 prot., datë 16.2.2022 (në cilësinë e përfaqësuesit të shtetit si pronar i aksioneve të subjektit prodhues, i ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik), i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë për miratimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal.

- Palët respektivisht KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. kanë referuar si bazë ligjore, VKM-në nr. 456, datë 29.6.2022. Kjo reference ligjore është e saktë, por e paplotë, pasi kjo VKM shtrin efektet nga data 29.6.2022 e në vijim, ndërkohë kontrata e referuar në ERE shtrin efektet për periudhën 1.1.2022–31.12.2022.

- Në pikën 2 të VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, rezulton se VKM-ja nr. 244/2016 dhe VKM-ja nr. 620/2021. të ndryshuara, shfuqizohen. Për periudhën 1 janar 2022 e deri në momentin e hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 456, datë 29.6.2022, marrëdhëniet ndërmjet palëve janë rregulluar bazuar në VKM-në nr. 620, datë 22.10.2021, “Për miratimin e kushteve, për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe për përballimin e parandalimin e saj, ndryshuar me VKM-në nr. 757, datë 9.12.2021. Në këtë kontekst Palët duhet të rishikojnë kontratën e nënshkruar ndërmjet tyre, duke marrë në konsideratë VKM-të e sipërcituara dhe periudhat për të cilat ato kanë efekte juridike. Pasi për periudhën 1.1.2022–31.12.2022, VKM-të kanë fuqi juridike për pjesë të ndryshme të vitit.

- Kërkesa e përbashkët e shoqërive KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., për miratimin e kontratës me nr. 4845 prot., të KESH sh.a., datë 30.9.2022., dhe me nr. 6926 prot., të FSHU sh.a. datë 30.9.2022, konsiston në miratimin e kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti (KESH sh.a.) dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a. për periudhën kohore 1.1.2022–31.12.2022.



- Kërkesa e palëve konsiston në miratimin e kontratës tip, por në të njëjtën kohë kontrata tip e mëparshme e miratuar nga ERE, me vendimin nr. 73, datë 22.4.2020, ndryshuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 4, datë 15.1.2021, nuk është për një afat të përcaktuar kohor sikurse kërkuar nga palët për kontratën e re për periudhën kohore 1.1.2022–31.12.2022.

- KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. duhet të bëjnë saktësimet përkatëse nëse kontrata e përcjellë në ERE është një kontratë tip që do të përdoret për çdo rast ndërmjet palëve apo është një kontratë vetëm për një periudhë të caktuar kohore.

- Në nenin 2 të kontratës së nënshkruar përcaktohet, se:

- Sasia e kontraktuar, e nominuar për vitin, që shitësi është i detyruar të furnizojë blerësin, është e gjithë sasia e nevojshme për plotësimin e kërkesës së plotë të blerësit, kjo referuar programeve mujore/javore/ditore/*intra-day*, sipas parashikimeve të neneve 4 dhe 5 të kësaj kontrate.

- Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për vitin 2022 është ai i miratuar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shitësit nr. 1394/1 prot., datë 16.2.2022, i ndryshuar, dhe sipas këtij vendimi është 2.6 lekë/Kwh për energji, e cila shërben për furnizimin nga FSHU-ja të klientëve të lidhur në rrjetin e shpërndarjes të tensionit të ulët, 0.4 kV dhe 12 lekë/kwh për energjinë që shërben për furnizimin nga FSHU-ja si Furnizues i Mundësisë së Fundit (FMF) të klientëve të lidhur në rrjetin e shpërndarjes së tensionit të mesëm 6/10/20 kV.

- Çmim i përdorur për këtë kontratë është ai i Asamblesë së Përgjithshme të Shitësit nr. 1394/1 prot., datë 16.2.2022, i ndryshuar, dhe sipas këtij vendimi është 2.6 lekë/kwh. Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 242, datë 23.9.2022, vendosi mbi kërkesën e shoqërisë FSHU sh.a., lidhur me kostot që duhet të përfshihen në llogaritjen e çmimit me pakicë të energjisë për klientët familjarë me konsum mbi 800 kwh në muaj.

- Vlerësohet, se: “Detyrimi i shërbimit publik i vendosur nga Këshilli i Ministrave, ndër të tjera përcakton detyrimin e KESH sh.a., për furnizimin me energji elektrike për të gjithë klientët të cilët furnizohen në kushtet e shërbimit universal nga FSHU sh.a. Në përputhje me VKM-në e sipërcituar, Asambleja e Përgjithshme e Aksionarit të KESH sh.a., me anë të vendimit nr. 6645/1, datë 8.9.2022 ka vendosur në pikën 1 të tij, miratimin e

çmimit të shitjes së energjisë elektrike për FSHU sh.a., sipas tabelës vijuese”:

Energji e shitur për konsum klientë familjar në TU, deri në 800 KWh/Muaj	2.6 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum klientë familjar në TU, mbi 800 KWh/Muaj	34.3 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum klientë jo familjar në TU	2.6 ALL/KWh
Energji e shitur për konsum klientë në Tension të mesëm TM, 6/10/20 KV	12 ALL/KWh

- Në këto rrethana vlerësohet se në kontratën e nënshkruar nga palët dhe të përcjellë në ERE nuk është reflektuar vendimi i Bordit të ERE-s nr. 242, datë 23.9.2022, si dhe në vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarit të KESH sh.a., nr. 6645/1, datë 8.9.2022.

- Gjithashtu, pika 4 e kontratës tip evidenton dhe kërkesën vjetore për energji elektrike, në këto rrethana evidentimi i kërkesës në nenin 2, pika 1, e kontratës së propozuar do të çonte në dhënien e një sasi indikative/të planifikuar, e cila do të evidentonte dhe sasinë vjetore të energjisë elektrike, e cila rregullohet me programet në vijim mujore/javore/ditore/*intra-day*. Për rrjedhojë, palët KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. duhet të evidentojnë sa më sipër në kontratën ndërmjet tyre, në mënyrë që të ketë dhe një sasi vjetore të programuar për këtë kontratë.

- Palët kanë bërë rregullimet përkatëse në kontratën me nr. 4845 prot., të KESH sh.a., datë 30.9.2022, dhe me nr. 6926 prot., të FSHU sh.a., datë 30.9.2022. Këto ndryshime prekin dhe elemente që lidhen me afatin e pagesave, e cila ndryshon nga 30 ditë në 45 ditë, po ashtu mënyrën e faturimit, e cila ndryshon dhe për faktin se FSHU sh.a. shërben dhe si FMF. Në këto kushte Palët KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. duhet të bëjnë me dije në ERE, nëse ndryshimet në kontratë sjellin kosto shtesë për ato.

- Për rrjedhojë, është e nevojshme që palët të rishikojnë kontratën e përcjellë në ERE me shkresën e përbashkët të KESH sh.a., me nr. 4845/1 prot., datë 30.9.2022, dhe të FSHU sh.a. me nr. 6926/1 prot., datë 30.9.2022, kontratën me nr. 4845 prot., të KESH sh.a., datë 30.9.2022., dhe me nr. 6926 prot., të FSHU sh.a. datë 30.9.2022, duke reflektuar vlerësimet e sipërcituara.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Shoqëria e prodhimit të energjisë elektrike e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., të rishikojnë bazën ligjore, nenet 1, 2, 9, 14 dhe 21 të kontratës së dërguar në ERE me shkresën e përbashkët të KESH sh.a., me nr. 4845/1 prot., datë 30.9.2022, dhe të FSHU sh.a. me nr. 6926/1 prot., datë 30.9.2022, kontratën me nr. 4845 prot., të KESH sh.a., datë 30.9.2022., dhe me nr. 6926 prot., të FSHU sh.a. datë 30.9.2022.

2. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë të shoqëritë KESH sh.a., dhe FSHU sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 275, datë 27.10.2022

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË
“H&K@VALA MAR RESIDENCES”
SHPK, NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç” të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d”, 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator

të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, me nr. 1828/1 prot., datë 19.10.2022, “Mbi licencimin e shoqërisë “H&K@Vala Mar Residences” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 249, datë 22.9.2022, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “H&K@Vala Mar Residences” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 70/38 prot., datë 1.10.2022, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo të objeksioneve nga të tretët (data 13.10.2022), nuk rezultoi të ketë të tilla. Ndërsa me shkresën nr. 1555/1 prot., datë 4.10.2022, ERE i është drejtuar shoqërisë me “Njoftim vendimi” duke qenë se në këtë aplikim nuk u konstatuan mungesa.

- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, nga ERE, në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi duhet të depozitojë në ERE: formatin dhe dokumentacionin për aplikim; dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor; dokumentacionin financiar dhe fiskal; si dhe dokumentacionin teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Sa rezulton nga ky aplikim shoqëria ka përcjellë tërësisht dokumentacionin e kërkuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “H&K@Vala Mar Residences” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 276, datë 27.10.2022

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB
ENERGY TRADE” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “P”, nenit 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1829/10 prot., datë 24.10.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi

fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Alb Energy Trade’ sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Alb Energy Trade” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1840 prot., datë 19.10.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “Alb Energy Trade” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat “a”, “b” dhe “c”, për pikën 1.2, germat “a” dhe “d”, për pikën 1.3, germa “c” dhe për pikën 2.5, germat “a”, “b” dhe “c”.

- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni, si vijon:

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”:

- Germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshminë e penaltetit) për shoqërinë dhe administratorin e saj.

- Germa “c”: Shoqëria duhet të bëjë saktësimet përkatëse mbi numrin e administratorëve të saj dhe të sjellë informacion nëse është miratuar versioni final i organigramës së saj.

Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”:

- Germa “a”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin mbi shlyerjen e detyrimeve ndaj Institucionit të Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore.



- Germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE letren e interesit të lëshuar nga banka, ku të referohet financimi për ushtrimin e veprimtarisë për të cilën kërkon të licencohet, pra furnizimi me energji elektrike ose të depozitojë vërtetim bankar për disponimin e kapitalit fillestar dhe mundësinë e përdorimit të kësaj shume për ushtrimin e kësaj veprimtarie.

- Pika 2.5, “Dokumentacioni specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike”:

- Germa “d”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion mbi nivelin e tensionit që do të furnizojë klientët.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

2. Drejtorja e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrir Ahmeti

VENDIM

Nr. 277, datë 27.10.2022

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “BIGWIND” SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW, ME VENDNDODHJE NË FSHATIN DARZEZË, NJËSIA ADMINISTRATIVE DËRMENAS, BASHKIA FIER

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “a”, nenit 5, pika 1, germa “a” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullores për organizimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 27.10.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1829/9 prot., datë 24.10.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘BIGWIND’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier”,

konstatoi se:

- Shoqëria “BIGWIND” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1815 prot., datë 13.10.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier”.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e



prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); shtojcën 1, shtojcën 1A dhe shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit për licencim në zbatim të aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton, se shoqëria “BIGWIND” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin, në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”, pikën 1.2, gjerat “a” dhe “d”, pikën 1.3, gjerat “a” dhe “c”, si dhe pikën 2.1, gjerat “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Nga ky aplikim rezulton se mungon dokumentacioni, si vijon:

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”:

- Germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE dëshminë e penaltit për administratorin të lëshuar jo më parë se 1 muaj nga aplikimi, si dhe dëshminë e penaltit për shoqërinë “BIGWIND” sh.p.k.

- Germa “c”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE informacion mbi stafin teknik që do të në funksion të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

Pika 1.3, “Dokumentacioni financiar dhe fiskal”:

- Germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE letrën e referencës të lëshuar nga banka.

Pika 2, “Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës”:

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë, gjithashtu:

- Germa “a”: Shoqëria duhet të specifikojë tipin e centralit Fotovoltaik (*off-shore, on-shore* apo tjetër).

- ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, dhe nenit 5 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e

prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet, por duke qenë se jetëgjatësia e pritshme e centralit fotovoltaik është 25 vjet, atëherë ERE kushtëzohet nga kjo jetëgjatësi në dhënien e afatit maksimal për këtë licencë fotovoltaike, deri në 25 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “BIGWIND” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2 mw, me vendndodhje në fshatin Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, për një afat 25-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM Nr. 282, datë 7.11.2022

MBI ZGJATJEN E VENDIMMARRJES SË BORDIT TË ERE-s LIDHUR ME FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS SË SHOQËRISË “DOSKU-ENERGY” SHPK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; neneve 67 dhe 87, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të “Rregullores për



organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1885/3-1 prot., datë 7.11.2022, të drejtorive teknike, Sekretarit të Përgjithshëm dhe Këshilltares së Bordit, “Mbi zgjatjen e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë ‘Dosku-Energy’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Në adresën e postës elektronike të ERE (*e-mail*, datë 7.11.2022), protokolluar në ERE më datë 7.11.2022, me nr. 207/36 prot., përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k. ka paraqitur kërkesën për shtyrjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s lidhur me procedurën e nisur me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 188, datë 21.7.2022, për heqjen e licencës së shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k.

- Shoqëria, në kërkesën e saj pretendon, se: “Administrata e ERE-s do të vinte në dispozicion raportin paraprak me gjetjet përkatëse, në mënyrë që shoqëria “Dosku-Energy” sh.p.k. të kishte mundësi të njëjhej me to, të ushtronte të drejtën e mbrojtjes, të paraqitjes së provave dhe të dokumentacionit të nevojshëm, nëse do të ishte e nevojshme.

- Shoqëria “Dosku Energy” sh.p.k., në mbledhjen e datës 6.10.2022, dhe në vijim me *e-mail*, në datën 11.10.2022, ka kërkuar një kopje të të gjitha provave të paraqitura në ERE nga “C&S Construction Energy” sh.p.k., ERE, me shkresën nr. 207/33 prot., datë 28.10.2022, i ka dërguar kësaj shoqërie dokumentacionin e kërkuar.

- Ne nenin 67 të “Kodit të Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar, se: “organi publik, që është kompetent për marrjen e vendimit përfundimtar, mund të marrë edhe vendime të ndërmjetme, kur gjykohet se mosmarrja e masave të caktuara do të shkaktonte një dëm të rëndë e të pariparueshëm mbi interesin publik, apo të të drejtave ose interesave të ligjshëm të palëve.

Gjithashtu, në nenin 87, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” parashikohet se përpara se të merret vendimi përfundimtar, organi publik, njofton palën lidhur me të drejtën e saj për t’u dëgjuar.

- Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 67 dhe nenit 87 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, vlerësohet zgjatja e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s lidhur me procedurën e nisur me vendimin nr. 188, datë 21.7.2022, në lidhje me fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “Dosku-Energy” sh.p.k., deri në 30 ditë nga marrja dijeni e këtij vendimi.

- Pretendimi i shoqërisë që administrata e ERE-s duhet t’i vendoste në dispozicion “raportin paraprak me gjetjet përkatëse”, në mënyrë që shoqëria “Dosku-Energy” sh.p.k., të kishte mundësi të njëjhej dhe të ushtronte të drejtën për t’u mbrojtur, është i paqartë, pasi ERE nuk disponon dokumentacion me titull apo përmbajtjen e sipërcituar, ndaj vlerësohet që brenda datës 10.11.2022, shoqëria “Dosku-Energy” sh.p.k. të saktësojë objektin e kërkesës së saj të datës 7.11.2022, në lidhje me administrimin e dokumentacionit të kërkuar nga ana e saj.

- Me qëllim që t’i mundësohet ushtrimi i të drejtave që burojnë nga neni 87 i KPA-së, vlerësohet t’i lihet afat shoqërisë që brenda datës 18.11.2022, të paraqesë në ERE komente apo vlerësime të mundshme mbi dokumentacionin e dërguar me shkresën e ERE-s nr. 207/33 prot., datë 28.10.2022.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të zgjasë deri në 30 ditë vendimmarrjen e Bordit të ERE-s lidhur me fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë “Dosku Energy” sh.p.k.

2. Brenda datës 10.11.2022, shoqëria “Dosku-Energy” sh.p.k. të saktësojë objektin e kërkesës e saj të datës 7.11.2022, në lidhje me administrimin e dokumentacionit të kërkuar nga ana e saj.

3. Brenda datës 18.11.2022, shoqëria “Dosku Energy” sh.p.k. të parashtojë në ERE komente apo vlerësime mbi provat e administruara, si dhe çdo argument që i shërben ushtrimit të së drejtës për t’u dëgjuar dhe për t’u mbrojtur për aq sa është administruar nga shoqëria me shkresën e ERE-s nr. 207/33 prot., datë 28.10.2022.

4. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë “Dosku-Energy” sh.p.k., shoqërinë “C&S Construction Energy”



sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për këtë vendimarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 283, datë 7.11.2022

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALB
ENERGY TRADE” SHPK, NË
VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16 dhe të nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 4, pika 1, germa “e”, nenit 5, pika 1, germa “e” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe nenit 15 dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 7.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1885 prot, datë 4.11.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Alb Energy Trade’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike” dhe qëndrimin e këshilltares së Bordit,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 266, datë 14.10.2022, vendosi të mos fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, pasi dokumentacioni i depozituar nga shoqëria nuk ishte sipas ndryshimeve të rregullores të miratuar me vendimin e Bordit të ERE nr. 220/2022, si dhe nuk ishte realizuar pagesa e aplikimit për t’u licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Pas marrjes së këtij vendimi, me shkresën e protokolluar me nr. 1770/2 prot., datë 17.10.2022, shoqëria ka bërë me dije se ka kryer dhe diferencën e pagesës që përkon me pagesat e reja të aplikimit.

- ERE, me shkresën nr. 1770/3 prot., datë 25.10.2022, ka orientuar shoqërinë se nëse brenda 1 (një) muaji nga marrja dijeni e këtij vendimi për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin sipas kërkesave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dokumentacioni i paraqitur në aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

- Brenda afatit 1-mujor, sikurse përcaktuar në nenin 10, pika 7, të rregullores, shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1770/4 prot., datë 28.10.2022, ka paraqitur dokumentacion për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.5); shtojcën 1 dhe shtojcën 1E të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (aneksi A).

- Aplikuesi ka kryer për llogari të ERE-s pagesën, sipas përcaktimeve të aneksit A të rregullores.

- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “Alb Energy Trade” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 të rregullores për pikën 1.1, gjerat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gjerat “a” dhe “d”; për pikën 1.3, gjerat “a”, “b” dhe “c”, si dhe pikë 2.5 të rregullores. Nga ky aplikim rezulton se shoqëria duhet të plotësojë:

Pika 1.2, “Dokumentacioni juridik dhe administrativ”:

- Germa “b”: Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore (dëshminë e



penalitetit) për vetë shoqërinë “Alb Energy Trade” sh.p.k. dhe për administratorin e saj.

- Germa “c”: Aplikuesi duhet të bëjë me dije nëse është bërë miratimi i strukturës organizative të saj dhe në kuptim të kërkesave specifike të këtij neni, shoqërisë do t’i kërkohej informacion mbi stafin teknik që do të angazhohet me veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike në strukturën organizative përfundimtare të saj.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Alb Energy Trade” sh.p.k. në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 284, datë 7.10.2022

MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 150, DATË 10.6.2022, “MBI RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË ‘DANSKE COMMODITIES ALBANIA’ SHPK, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së

Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 7.11.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1885 prot, datë 1.11.2022, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s n. 150, datë 10.6.2022, ‘Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Danske Commodities Albania’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike” dhe qëndrimin e Këshilltares së Bordit,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 150, datë 10.6.2022, ka vendosur:

- Të rinovojë licencën e shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., me nr. 374, seria T12/T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 94, datë 4.7.2017, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar), duke filluar nga data 4.7.2022.

- Shoqëria “Danske Commodities Albania” sh.p.k., në përfundim të procesit të vlerësimit nga organi tatimor, të paraqesë në ERE, vërtetimin e detyrimeve tatimore të pastër.

- Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, në varësi të vendimmarrjes së organit tatimor në përfundim të procesit të vlerësimit mbi procesin e apelimit të nisur nga shoqëria “Danske Commodities Albania” sh.p.k., që mund të ndryshojë rrethanat e kësaj vendimmarrjeje.

- ERE njoftoi shoqërinë për këtë vendimmarrje me shkresën nr. 477/4 prot., datë 17.6.2022.

- Me dokumentacionin e depozituar me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 477/5 prot., datë 17.10.2022, shoqëria ka plotësuar kushtin e vendosur në pikat 2 dhe 3 të vendimit nr. 150/2022.

- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit, që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të shfuqizojë pikën 2 dhe pikën 3 të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 150, datë 10.6.2022, “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

KËRKESË

Nr. 623/11, datë 11.11.2022

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rikonstruksion i rrugës ekzistuese ‘Grigor Nosi’, Hasan Ali Kopili’ dhe ‘Xhaferr Dubanxhiu’ në ZK 8527”, Bashkia Elbasan, me vlerë totale paraprake të shpronësimit 4,092,507.34 (katër

milione e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëqind e shtatë pikë tridhjetë e katër) lekë.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Elbasan.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohet sipas vlerësimit paraprak të llogaritur:

- Për pasuritë e llojit “truall”, “ullishte” dhe “pemëtores” është bërë bazuar në VKM nr. 138, datë 23.8.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar, dhe në VKM nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara, për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Elbasan, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 4,092,507.34 (katër milionë e nëntëdhjetë e dy mijë e pesëqind e shtatë pikë tridhjetë e katër) lekë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahim



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, NGA PROJEKTI “RIKONSTRUKSION I RRUGËVE EKZISTUESE ‘GRIGOR NOSI’, ‘HASAN ALI KOPILI’ DHE ‘XHAFERR DUHANXHIU’ NË Z. K. 8527”, ELBASAN

NR.	PRONARI			TË DHËNA HIPOTEKORE										VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM						Vlera totale	SHËNIME (DHE/ Kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
														"ARE"			"TRUALL"				
	EMRI	ATËSIA	MBIEMRI	Fshati ose qyteti	Zona Kadastrale	Nr. pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja Totale	"Are" (m2)	"Truall" (m2)	"Ndërtesë" (m2)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (lek/m ²)	Vlera (lek)		
1	A	B	C	C	Ç	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	Z	
	BURBUQE	HYSEN	STRUGU	ELBASAN	8527	1374/J18	ULLISHTË	10813.01	10813.01	0	0	19	232	96.6	222	21,445.20	0	0	0	21,445.20	Nuk ka
	HEDUE	YMER	HAXHIMUSAJ																		
	MIRELA	MUSTAFA	SHOPI																		
	MYZEJEN	HYSEN	STRUGU																		
	AGIM	YMER	HAXHIMUSAJ																		
	SANUE	YMER	BAKALLI																		
	HATIXHE	MUSTAFA	KARKANAQE																		
	AFERDITA	YMER	HASEQUI																		
	ANILA	MUSTAFA	KATRO																		
	LUMTURI	HYSEN	FUGA																		
	MIMOZA	MUSTAFA	CEKA																		
	FLORINDA	HYSEN	FUGA																		
FERDINAND		STRUGU																			
2	SANUE	YMER	BAKALLI (HAXHIMUSAJ)	ELBASAN	8527	1374/33	ULLISHTË	7922.74	7922.74	0	0	20	39	194	222	43,068.00	0	0	0	43,068.00	Nuk ka
	MYZEJEN		STRUGU																		
	MIRELA	MUSTAFA	SHOPI																		
	LUMTURI		FUGA (STRUGU)																		
	HEDUE	YMER	HAXHIMUSAJ																		
	HATIXHE	MUSTAFA	SHOPI (KARKANAQE)																		
	FLORINDA		FUGA (STRUGU)																		
	FERDINAND		STRUGU																		
	BURBUQE		STRUGU																		
	ANILA	MUSTAFA	KATRO (SHOPI)																		
	AGIM	YMER	HAXHIMUSAJ																		
	AFERDITA	YMER	HASEQUI (HAXHIMUSAJ)																		
	MIMOZA	MUSTAFA	SHOPI (CEKA)																		
3	OMER	AZMI	STRINGA	ELBASAN	8527	1373/72	PEMETORE	3465	3465	0	0	17	101	211	222	46,842.00	0	0	0	46,842.00	Nuk ka
	ARBEN	AGRON	STRINGA																		
	ERVIN	MUSTAFA	LAMÇJA																		
	GLADIOLA	AGRON	STRINGA																		
	LILJANA	MUSTAFA	LAMÇJA																		
	LUMNUJE	ZIJA	LUNIKU																		
	MERITA	MUSTAFA	LAMÇJA																		
	PRANVERA	AZMI	HAMZAJ																		
	VJOLLÇA	ZIJA	LUNIKU																		
	BENON	MUSTAFA	LAMÇJA																		
	BRIKENA	SEZAI	HAXHADEMI																		



	ALEMSHA	AZMI	BOLLANO																		
4	DALIP	KADRI	BAKALLI	ELBASAN	8527	1373/5	ULLISHTË	1709.64	1709.64	0	0	11	114	13.8	222	3,063.60	0	0	0	3,063.60	Nuk ka
	FATUSH		BAKALLI																		
	NASHIFER		BAKALLI																		
	MELEQ		BAKALLI																		
	KADESHE		BAKALLI																		
	MUSA		BAKALLI																		
	SHEJNAZ		BAKALLI																		
	BURBUQE		BAKALLI																		
	DRITAN	SADIK	CENGELI																		
5	YLLI	ASLLAN	RUCI	ELBASAN	8527	1373/6	TRUALL	408.1	0	408.1	103.24	11	112	0	0	-	44.35	12764	566,083.40	566,083.40	Nuk ka
6	LULZIM	KAMER	MUZHAKI	ELBASAN	8527	1372/102	TRUALL	137.1	0	137.1	0	17	247	0	0	-	33.8	12764	431,423.20	431,423.20	Nuk ka
7	DALIP	KADRI	BAKALLI	ELBASAN	8527	1372/87	ULLISHTË	9677.8	9677.8	0	0	17	136	176	222	39,072.00	0	0	0	39,072.00	Nuk ka
	DRITAN	SADIK	CENGELI																		
	FATUSH		BAKALLI																		
	NASHIFER		BAKALLI																		
	MELEQ		BAKALLI																		
	KADESHE		BAKALLI																		
	MUSA		BAKALLI																		
	SHEJNAZ		BAKALLI																		
BURBUQE		BAKALLI																			
8	HAVA	RRAPUSH	HASA	ELBASAN	8527	1340/14	TRUALL	445.9	0	445.9	78.6	19	52	0	0	-	76.8	12764	980,275.20	980,275.20	Nuk ka
	LORIS	FATMIR	HASA																		
	ERALD	FATMIR	HASA																		
	MEJTIM	FATMIR	HASA																		
	SONILA	FATMIR	HASA																		
9	DALIP	KADRI	BAKALLI	ELBASAN	8527	1362/31/2	ULLISHTË	9236.7	9236.7	0	0	19	61	90.9	222	20,179.80	0	0	0	20,179.80	Nuk ka
	DRITAN	SADIK	CENGELI																		
	FATUSH		BAKALLI																		
	NASHIFER		BAKALLI																		
	MELEQ		BAKALLI																		
	KADESHE		BAKALLI																		
	MUSA		BAKALLI																		
	SHEJNAZ		BAKALLI																		
BURBUQE		BAKALLI																			
10	DILE	BANUSH	DEDA	ELBASAN	8527	8/3	TRUALL	421.7	0	421.7	139.7	1	242	0	0	-	41.57	12764	530,599.48	530,599.48	Ndalohej veprimet mbi pasuritë deri në zgjidhjen e problemit të krijuar nga regjistrimi i parregullt në sistemin hipotekor dhe hiqet kufizimi më datë 11.1.2017 pasi në vëm nr. 678 datë 28.9.2016 është bërë shpronësimi i pronarit dhe nuk ka më mbivendosje me pasuri të tjera, heqje kufizimi.
11	AFERDITA	IBRAHIM	MUSMUÇA	ELBASAN	8527	1415/99	ULLISHTË	5133.4	5133.4	0	0	12	241	73.17	222	16,243.74	0	0	0	16,243.74	Kufizohet pasuria sipas nenit 59 të ligjit 33/2012 "Për regjistrimin e pasurive të



																					paqatshme", sipas kërkesës së bërë nga Mithat Kokunja deri në paraqitjen e një vendimi gjykatë të formës së prerë që të ketë trashëgimtarët e së ndjerës Mereme Huta (Ashiku), kufizim.
12	FATMIR	SELIM	TANUSHI	ELBASAN	8527	1362/32	TRUALL	339.2	0	339.2	100.5	13	218	0	0	-	5.5	12764	70202	70,202.00	Nuk ka
13	BAKI	SUL	DURAKU	ELBASAN	8527	1374/30	TRUALL	496.1	0	496.1	113.7	16	217	0	0	-	103.73	12764	1,324,009.72	1,324,009.72	Nuk ka
14	SHTET			ELBASAN	8527	1340/1	TRUALL	614	0	614	0	6	142	0	0	-	191.6	12764	0	-	Kjo pasuri është e okupuar nga Artan Nuredini, ka një ndërtim pa leje
15	SHTET			ELBASAN	8527	1340/13	TRUALL	59.5	0	59.5	0	19	51	0	0	-	15.97	12764	0	-	Nuk ka
16	SHTET			ELBASAN	8527	1340/15	TRUALL	20.6	0	20.6	0	19	53	0	0	-	4.7	12764	0	-	Nuk ka
17	SHTET			ELBASAN	8527	1340/10	TRUALL	152	0	152	0	6	129	0	0	-	45.1	12764	0	-	Nuk ka
18	SHTET			ELBASAN	8527	1340/7	TRUALL	594	0	594	0	7	98	0	0	-	7.8	12764	0	-	Nuk ka
19	SHTET			ELBASAN	8527	1340/11	TRUALL	247	0	247	0	6	27	0	0	-	49.32	12764	0	-	Kjo pasuri është e okupuar nga ramazan Qerim Xherri, ka një ndërtim pa leje
20	SHTET			ELBASAN	8527	1380/116	TRUALL	365	0	365	0	6	28	0	0	-	48.85	12764	0	-	Kjo pasuri është e okupuar nga Erjon Bajram Zerellari, ka një ndërtim pa leje
21	SHTET			ELBASAN	8527	1378/1	TRUALL	244	0	244	0	7	32	0	0	-	0.85	12764	0	-	Kjo pasuri është e okupuar nga Gani Jaho Tanushi, i cili ka 2 ndërtime pa leje
	SHUMA TOTALE																		4,092,507.34		

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2022

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 160 lekë